



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe votimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895, date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar” (*Nismë deputetësh*) (*Komision për dhenie mendimi*)

2. Shqyrtimi dhe votimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë ERE për vitin 2018” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermeni, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi, Zef Shtjefni dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Ilir Ndraxhi dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Artan Syziu - Përgjegjës Sektori në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

Esmeralda Velaj – Specialiste në Drejtorinë e Vlerësimit të Legjislacionit

Kleves Janku – Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë

Klodiana Marika – Përfaqësuese e Ministrisë së Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit për ditën e sotme. Sot në rendin e ditës si pikë të parë kemi vazhdimin e diskutimit dhe të miratimit në parim, nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895, date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar””. Ndryshimet vijnë si një nismë deputetësh. Për këtë projektligj seancën e kaluar ka relatuar zoti Besnik Baraj, ku kemi bërë edhe diskutimet me prezencën e përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë, të Prokurorisë, të Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu sot të pranishëm në komision janë përfaqësues nga Prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë dhe presim të na bashkohen përfaqësues edhe nga Ministria e Bujqësisë.

Ndërkohë, meqë mbledhjen e kaluar kemi ezauruar pjesën e pyetjeve, të përgjigjeve dhe të diskutimeve, propozoj të kalojmë në miratimin në parim dhe më pas në diskutimin dhe miratimin nen për nen, ku kemi edhe disa rekomandime nga institucione të ndryshme, pasi kemi bërë dëgjuesën me grupet e interesit dhe propozimet e tyre janë regjistruar. Kemi kaluar në parim dhe kemi kryer punën më të madhe sa i takon nismës të një numri prej më shumë se 37 000 qytetarësh, për ndryshimet e Kodit Penal në raport në mirëqenien e kafshëve, të cilat i kemi kaluar në parim dhe ia kemi kaluar Komisionit të Ligjeve për t’i akomoduar në ndryshimet e tjera të Kodit Penal, duke bërë adoptimet e nevojshme të harmonizimit të masave ndëshkimore në raport edhe me veprat e tjera penale.

Sot, propozoj, së pari, të bëjmë miratimin në parim të këtij projektligji dhe më pas ta diskutojmë nen për nen.

A ka ndonjë mendim tjetër?

Halit Valteri – Mirëmëngjesi!

Unë mendoj që në fillim t’i diskutojmë nen për nen dhe më pas ta miratojmë projektligjin, sepse kemi disa gjëra që i kemi përgatitur për disa pika të këtij ligji.

Niko Peleshi – Ne patjetër që do ta diskutojmë nen për nen...

(Diskutime pa mikrofon)

Në parim, nuk besoj të jemi kundër për ndryshimet në Kodin Penal në këto fusha ku...

Halit Valteri– Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ne duhet ta kalojmë në parim projektligjin dhe më pas të diskutojmë nen për nen dhe në këtë mënyrë gjithçka ecën normalisht.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Kush është dakord për miratimin në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895, date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në parim.

Fillojmë me diskutimin nen për nen. Përpara keni një tabelë me disa kolona, ku në kolonën e parë është ligji; në kolonën e dytë projektligji, propozimet e ndryshime; në kolonën e tretë janë komentet e komisionit dhe të grupeve të interesit dhe kolona e katërt ka disa propozime për riformulim nga Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Neni 1 i projektligjit i referohet nenit 50, pra bëhen ndryshime në nenin 50 të ligjit për Kodin Penal, të cilin po jua lexoj meqë është neni i parë dhe më pas do të vazhdojmë me radhë.

Në nenin 1 thuhet që, për nenin 50 shtohet germa “f/1” me këtë përmbajtje: “Kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë”.

Ne si komision nuk kemi komente dhe propozime për riformulim për këtë nen. A ka ndonjëri prej jush ndonjë mendim apo diskutim?

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2, i cili bën ndryshime në nenin 96 dhe e ndryshon, siç është e shkruar më poshtë, i cili ka lidhje me neglizhencën në trajtimin mjekësor. Pra, në këtë nen thuhet: “Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e profesionistit shëndetësor ose e personelit ndihmës kur ka rrezikuar jetën e personit apo ka shkaktuar gjymtimin e tij të përhershëm dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e profesionistit shëndetësor ose e personelit ndihmës, kur ka shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burgim deri në 4 vjet. Po kjo vepër kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet”.

Në tabelë nuk ka komente.

Po, fjalën e ka kërkuar zoti Gjuzi. Më pas fjalën e kanë zoti Valteri dhe zoti Beqaj.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe radhën e shkuar kishim disa komente për afatin e burgimeve, prandaj mendoj të jemi më të kujdesshëm, duke marrë shkas edhe nga një vizitë e fundit që kam pasur në burgjet shqiptare.

Niko Peleshi – Në sensin që duket e rënduar, duhet zbutur apo duhet ashpërsuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet zbutur.

Po, zoti Valteri e ka fjalën.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk ka ndonjë gjë, por ne do t’ia rekomandojmë Komisionit të Ligjeve ta shohë.

Halit Valteri – Të nderuar kolegë,

Fjala “neglizhencë” në një ligj më duket pak abstrakte, sepse nuk ka masë, nuk kemi si ta matim, është evazive. Unë propozoj që fjala “neglizhencë” në këtë nen të zëvendësohet me fjalën “refuzim”, pra ti refuzon të japësh ndihmën e parë pacientit dhe atëherë dënohesh, ndërsa me fjalën “neglizhencë” nuk ke si ta matësh, kështu që ajo lë vend për interpretim. Edhe zotërinjtë e prokurorisë, kur të ngrenë një akuzë, nuk kanë si ta matin atë me fjalën “neglizhencë”, ndërsa nëse vendosim fjalën “refuzon” dhe ai refuzon ta japë ndihmën e parë pacientit, atëherë kjo merr një nocion të plotë, sepse je më i saktë te kjo pjesë.

Artan Syziu – Pra, që propozimi të mos mbetet ashtu siç është, në vend të fjalës “neglizhencë” të përdoret fjala “pakujdesi”, sepse neglizhenca është një nga format e pakujdesisë, ndërsa pakujdesia përfshin edhe vetëbesimin e tepruar. Çfarë është neglizhenca dhe vetëbesimi i tepruar? Të dyja këto janë terma teknikë dhe për të arritur në një konkluzion nëse jemi apo jo përpara një vepre penale zhvillohen hetime që mund të shkojnë me qindra dhe mijëra faqe, sepse thirren ekspertë mjeko-ligjor, ekspertë të fushave e kështu me radhë.

Unë propozoj që në vend të fjalës “neglizhencë” të përdoret fjala “pakujdesi”, që përfshin edhe vetëbesimin e tepruar.

Për t’jua ilustruar dhe për t’jua bërë më të kuptueshme po ju përmend një shembull. Në rast se një fëmijë shkon te mjeku dhe është me diabet dhe mjeku i injekton glukozë pa i bërë asnjë analizë, ky është vetëbesim i tepruar dhe është më i rëndë sesa neglizhenca. Këto janë raste konkrete në praktikë.

Në rast se prindërit dërgojnë një fëmijë te mjeku dhe i thonë se fëmija nuk merr dot frymë, ndërsa mjeku u thotë çojeni në shtëpi se nuk ka asgjë dhe fëmija vdes, sepse mjeku nuk i

ka bërë asnjë ekzaminim, ndërsa fëmija ka një material bllokues në frymëmarrje. Pra për këtë rast sigurisht që mjeku duhet të përgjigjet.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

E para, duhet të kemi parasysh që mjekësia nuk është shkencë ekzakte. Sado të zhvillohet teknologjia, instikti dhe eksperiencia e mjekut me të parë dhe me të prekur nuk mund të zëvendësohen asnjëherë me asnjë lloj pajisje. Ne nuk mund të dalim në vlerësime pa referuar këtu edhe protokollet mjekësore. Vërtet vijnë prindërit dhe thonë fëmija nuk merr frymë, por ka një protokoll mjekësor, si dhe një udhëzues klinik në rast se paraqitet një person që nuk merr frymë, ku janë të renditura një, dy, tre apo katër gjëra. Pra, nesër do të duhet t’i referohemi respektimit ose jo të udhërrëfyesit klinik apo protokolleve, kapërcimin nga vetëbesimi apo neglizhenca për të arritur këtu.

Unë mendoj se ne këtu duhet të përfshijmë ose të rekomandojmë që referenca duhet të jetë me akte mjekësore të miratuara nga organet kompetente...

(Diskutime pa mikrofon)

Ja sa të mbaroj me të gjitha ato që unë kam për këtë nen në mënyrë që të mos humbasin kohë.

E dyta, jam dakord me propozimin për pakujdesinë e neglizhencës, por jo me trajtim, por me kujdes, sepse kujdesi është më i gjerë sesa trajtimi dhe ka përkufizime sa i takon kujdesit mjekësor.

Sa i takon frazës: “Nga ana e profesionistit shëndetësor ose personelit ndihmës” mendoj se “personelit ndihmës” duhet hequr, pasi profesionisti shëndetësor i përfshin të gjitha. Po t’i kthehi vitit 1994, ka qenë mjek ose personel tjetër mjekësor, sepse personeli ndihmës në spital është edhe sanitari. Çfarë pune ka sanitari në këtë rast? Atëherë, unë mendoj se duhet të themi “personeli ndihmës shëndetësor”, sepse ky term është mjaft i gjerë. Personel ndihmës është edhe oksigjenisti, kaldajisti, sepse edhe ai krijon një mjedis.

Për mua mjafton “profesionisti shëndetësor”, sepse sot çdo njeri që punon me qytetarin hyn te profesionet e rregulluara. I tillë është mjeku, farmacisti, dentisti, mamia, fizioterapisti, tekniku i laboratorit e kështu me radhë.

Sa i takon specifikës së trajtimit të veçantë të HIV/AIDS ka ardhur koha ta heqim dhe ta lëmë si gjithë të tjerat, për një arsye shumë të thjeshtë. Në vitin 1994 HIV/AIDS ishte sëmundje vdekjeprurëse, ndërsa sot është sëmundje e kurueshme, madje e shërueshme.

Faleminderit!

Artan Syziu – Nuk ka asnjë procedim penal të regjistruar për mjekim të pakujdesshëm që të mos kryhet ekspertim mjeko-ligjor nga grupe ekspertësh të Institutit të Mjekësisë Ligjore në përbërje të të cilit, sipas rasteve specifike, marrin pjesë edhe specialistë të fushave përkatëse, si kardiologë, otorinolaringolog e kështu me radhë. Pra, nuk është prokurori apo oficeri i Policisë Gjyqësore ai që shkon dhe bën një vlerësim subjektiv për protokollin mjekësor, por e bëjnë specialistët e fushës...

(Diskutime pa mikrofon)

Patjetër!

Kjo është një dispozitë dhe nuk mund të shkojë përtej kësaj. Ajo që ne kemi propozuar është që në krahasim me dispozitën ekzistuese, përfshihet vetëm gjymtimi, por, në fakt, duhet të jetë me koherencë me plagosjen e rëndë, gjymtimi është vetëm njëra anë e plagosjes së rëndë. Pra, mund të ndërpresë shtatzaninë, mund të shkaktojë një lloj tjetër dëmtimi, si shëmtimi i përhershëm i fytyrës, por, gjithashtu, është mjekim i pakujdesshëm, sepse kur sjell shëmtimin e përhershëm të fytyrës nga ana e këtyre që kryejnë sot operacione estetike, është mjekim i pakujdesshëm.

Niko Peleshi – Zonja Gjermani, e ka fjalën.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Unë jam dakord me kolegun Beqaj sa u takon protokolleve, por nuk jam 100% e sigurt nëse kemi protokolle dhe udhëzues për të gjitha fushat dhe procedurat. Gjithsesi kam një sugjerim, meqenëse ky është nen specifik dhe besoj që Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë do të bëjë një formulim ezaurues në si Komisioni Veprimtarisë Prodhuese mund të sugjerojmë ose të japim mendim për këtë nen në mënyrë specifike dhe ta lëmë që riformulimi të bëhet nga ky komision, Komisioni i Shëndetësisë, i cili është profesionist dhe ka ekspertizën për ta bërë plotësisht këtë gjë.

Niko Peleshi – Po, zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Në nenin 96 kam diçka sa i takon masës së gjobës dhe të burgimit që është deri në 2 vjet. Unë nuk jam për burgim deri në 2 vjet, por deri në 3 vjet.

Sa i takon pjesës së dytë në të cilën thuhet: “Për vdekjen e personit dënohet me burgim deri në 4 vjet”, unë jam për 6 vjet burg.

E treta: “dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet”, unë jam për 2 deri në 6 vjet burg. Është pjesa ku flitet për masën e dënimit. Kjo gjë duhet parë me kujdes, kanë vdekur njerëz, pasi në raste të tjera ka ndodhur që personi nuk është më në gjendje pune, sepse është i gjymtuar, presupozohet që mund të vdesë, prandaj mendoj që kjo gjë të rishikohet nga specialistët që janë për këtë punë.

Nimet Musaj – Faleminderit, kryetar!

Duke parë këtë nen dhe duke i dëgjuar kolegët, e vërteta është që në Komisionin e Shëndetësisë, nga kontaktet që kam pasur, e kam parë pak me skepticizëm këtë gjë dhe termat që ne duhet të përdorim në këtë komision duhet të jenë specifike dhe precize. Pra, jo se ne nuk kemi vendimmarrje, por ky komision, duke u nisur edhe nga specifikat që ka profesionalizmi mund të sjellë diçka të re, të cilën ne nuk e kemi sot në mendimet tona.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi, kishit ndonjë gjë?

Kujtim Gjuzi – Po jua risjell edhe një herë në vëmendje çështjen e burgimeve. Unë mendoj se dënimet janë të rënda, prandaj duhen parë edhe një herë me kujdes, si edhe nga ana e prokurorëve, sepse edhe ata nuk janë për t’i rënduar burgosjet. Ndryshimi i ligjit do të bëjë që mjekët të jenë më të vëmendshëm ndaj pacientëve, prandaj edhe ne duhet të jemi më të kujdesshëm sa u takon dënimeve, sepse burgjet i kemi plot.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Të lutem, Ilir më korrigjo, sepse nuk e kam ndjekur shumë këtë gjë si diskutim, por me aq sa unë di, ideja për ndryshimin e këtij neni ishte që të dekriminalizohet pakujdesia, ndaj është përdorur fjala neglizhencë. Me aq sa më kanë thënë nga Komisioni i Shëndetësisë ata i janë referuar edhe legjislacionit të vendeve të zhvilluara europiane ku është pak më e specifikuar. Unë, personalisht do të isha dakord logjikisht me propozimin e zotit Beqaj, por siç e tha edhe zonja Gjermani, nuk jam i sigurt nëse ekzistojnë të gjitha protokollet, por ne duhet ta lidhim neglizhencën me protokollin. Në rastin mosrespektimit të protokolleve aty ku ato janë themeluar, konsiderohet neglizhencë dhe më pas vlejné masat e ndëshkimeve penale apo administrative.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Nëse dikush do të thotë që në 15 raste të ngjashme ke bërë 7 ekzaminime dhe në 8 raste nuk ke bërë asnjë, edhe nga eksperiencia kuptohet shmangia nga praktika, sepse ajo pastaj është çështje individuale...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi - Tendenca është për ta zbutur këtë pikë të nenit në kuptimin e dekriminalizimit të pakujdesisë. Pra, nuk mund të quhet më krim një problem shëndetësor, që mund t'i shkaktohet pacientit për shkak të pakujdesisë...

(Diskutime pa mikrofon)

Në këtë nen kemi termin “pakujdesi”, që zëvendësohet me termin “neglizhencë” dhe synimi është ta zbusim atë.

Esmeralda Velaj – Pikë së pari, këto ndryshime kanë ardhur në mënyrë që të mos rëndohet pozita e mjekut në këtë fushë, pasi ata janë përballë çdo problematike mes të sëmurëve dhe kanë një mision dhe detyrë shumë të vështirë.

Termi “pakujdesi” është i njohur nga Kodi Penal, por pakujdesia në vetvete ka të përfshirë edhe elemente të tjera. Një nga këto elemente është mendjelehtësia, domethënë, duke parë edhe doktrinat penale, këtu përfshihet edhe pakujdesia, në aspektin e ngushtë, përfshihet edhe gabimi njerëzor, përfshihet edhe paaftësia dhe neglizhenca.

Për sa i përket “neglizhencës” si term, jemi konsultuar edhe me mjekët (duhet të jetë një term që e njeh edhe Kodi Penal), është parë si element kur mjeku anashkalon edhe protokollet, që tha me të drejtë zoti Beqaj, dhe kjo do të thotë që ai nuk bën punën e tij, duke parashikuar edhe pasojat që mund të ndodhin. Kjo e rëndon pozitën e mjekut.

(Diskutim pa mikrofon)

“Refuzimi” pastaj është disi më i gjerë, ndërsa “neglizhenca” është term që e njeh doktrina penale dhe përfshihet në këto lloj pakujdesish.

Niko Peleshi - Më falni, se ju ndërpreva!

Kam përshtypjen që pakujdesia ka brenda edhe neglizhencën, edhe gabimin. Mund të jetë kjo që thotë Arditi. Pra, ne kriminalizojmë “neglizhencën” dhe dekriminalizojmë “gabimin”, duke specifikuar neglizhencën si kriminale.

Esmeralda Velaj – Mendoj që për këtë lloj definicioni duhet të merret edhe Komisioni i Shëndetësisë, bazuar edhe në mendimin e mjekëve. Neglizhenca është parë në këtë pikë, kurse

pakujdesia mund të përfshijë edhe dëshirën që një mjek mund të veprojë për të shpëtuar jetën e pacientit dhe mund të bëjë edhe një gabim njerëzor. Për këtë ai nuk mund të penalizohet.

Kurse për sa i përket marzhit të dënimeve, meqenëse e përmendëm disa herë, marzhi ka ndryshuar, ai ka qenë me gjobë deri në 5 vjet, neni 96 “Mjekimi i pakujdesshëm”, tani, sipas shkallës së dëmtimit përsëri, por është zvogëluar. Domethënë, mjeku nuk rëndohet në këtë rast me ndryshimin e tanishëm nga 5 vjet në 2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë bërë edhe analizat e kodeve të tjera, se nuk mund të themi që duhet të bëjmë një ndryshim nga 5 vjet në 2 pa e argumentuar.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Dua të bëj një përmbledhje me një fjali dhe pastaj përfaqësuesi i prokurorisë do të shtojë diçka, ndryshimi konsiston si më poshtë:

Në Kodin Penal bëhet fjalë për pakujdesi, pra spektri është shumë i gjerë nga “gabimi” deri te “neglizhenca”. Ndryshimi në këtë Kod kriminalizon vetëm neglizhencën dhe nënkupton që gabimi nuk konsiderohet më një vepër penale, siç e shpjegoi edhe zonja.

Urdhëroni!

Artan Syziu - Më falni që po e marr fjalën për të disatën herë!

Formulimi është i gabuar. Nuk mund të dënohet neglizhenca dhe të lihet pa u dënuar vetëbesimi i tepruar. Është njësoj si të thuash: “për vrasje, je i falur, për plagosje, dënohesh”. Më falni, por është pikërisht kështu. Më mirë t’ia lëmë Komisionit të Ligjeve.

Në qoftë se ne nuk dënojmë vetëbesimin e tepruar apo gabimin...

Halit Valteri - Gabimi që nuk përbën faj, nuk dënohet as me këtë ndryshim, as me tjetrin.

Niko Peleshi - Po cili quhet “gabim” dhe cili “vetëbesim i tepruar”? Ku ndahen?

(Diskutim pa mikrofon)

Po të lihet siç është, është e gabuar. Në praktikë do të ketë raste të rënda që do të mbeten pa u dënuar ose pa u vënë para përgjegjësisë penale.

Më falni që po e theksoj, por në burgje nuk ka mjekë fare. Ato mund të jenë të mbushur për drogë, por nuk ka asnjë të dënuar mjek. Mund të ketë mjekë të dënuar me punë të detyruar në interes publik, më e shumta, ose me gjobë, por asnjë nuk është i dënuar me burg, përkundrazi, ka viktima që nuk jetojnë më.

(Mungesë audio)

Niko Peleshi -Po “gabimi” pse nuk quhet “gabim”? Janë nocione juridike edhe “gabimi” edhe “vetëbesim i tepruar”?

Nuk po themi të na i mësoni edhe neve, por ekzistojnë, apo do të ngelen në diskrecionin e hetimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, flisni me mikrofon!

Artan Syziu - Ajo që duhet të bëjnë mjekët shqiptarë, është të bëjnë atë që bëjnë mjekët në botë. “Merri firmën”, që, bie fjala, pasi operacioni ka një risk. Kjo është e gabuar. Këtë nuk e bëjnë mjekët shqiptarë.

Niko Peleshi -Kam përshtypjen që mjekët shqiptarë (jo të gjithë) nuk zbatojnë protokollin. Ai është gabim, për mendimin tim.

Në qoftë se ne garantojmë që çdo mjek do të garantojë protokollin përkatës, besoj se do të shmangim shumë gabime.

Gjithsesi, unë nuk jam ekspert i kësaj fushe.

Urdhëroni, zoti Gjuzi dhe më pas fjala për zotin Valteri.

Kujtim Gjuzi – Ju na ilustruat me shembuj të thjeshtë (se duke mos qenë mjekë, ne nuk e kuptojmë), po marr marrjen e firmës, paraprakisht, nëse unë jap firmën, ajo dhënia e firmës nuk ma heq veprimin e mjekut që do ma shtyjë apo do të ma nxjerrë kockën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam te gabimi dhe te vetëbesimi i tepruar, që do të thotë se ne duhet ta sanksionojmë. Jam shumë dakord te pjesa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O zotëri, edhe ne këtë po themi, që ju si ekspert të na tregoni më shkoqur si ta bëjmë, edhe ne të dakordësohemi dhe ta bëjmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Pakujdesi” e kishim! Këtë na thuaj!

Artan Syziu – Mendoj se propozimi që është bërë nga një grup deputetësh ka pasur parasysh dy raste: “neglizhencën” duke parë krimet që janë kryer, pra ose është neglizhuar nga mjekët, njëkohësisht, propozimi tjetër, që bëhet nga një grup deputetësh, është për të ashpërsuar

masat ndaj atyre që ushtrojnë dhunë ndaj atyre që janë në detyrë. Këto dy koncepte janë mendoj unë, kështu që këtu duhet të jetë neglizhenca.

Kujtim Gjuzi – I nderuar prokuror, ju besoj se keni në fokus rastin e Elbasanit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, shkëlqesi, Prokuror!

Në këto momente që flasim kemi gati 2 mijë mjekë të larguar dhe, nëse ne do ta rëndojmë pozitën ndaj tyre, që janë në një farë mënyre “elita” që kujdesen për ne, do t’i trembim ata.

Unë ju ftoj, i nderuar prokuror, që ta formuloni ju në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mbrojtur qytetarin të parin, por njëkohësisht duke mos dëmtuar edhe pjesën e elitës sonë shkencore, sepse për t’u bërë mjek, duhen minimalisht 30 vjet shkollë dhe vetëm në moshën 45-vjeçare merr të gjithë titujt shkencorë.

Përfitoj nga rasti t’ju them, ju lutem të mos ma quani konflikt interesi, zonja ime është kardiologe dhe ajo thotë kështu: “Turni i natës është shumë i rrezikshëm, sepse kemi presing nga të gjitha anët dhe ne mund të bëjmë një gabim të mundshëm aty”. Ndaj, ju lutem, formulojeni në mënyrë të tillë që edhe ne të biem dakord.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Fjala për zotin Pëllumbi dhe më pas për zonjën Gjermani.

Arben Pëllumbi – Zoti kryetar, ky nen dhe ndryshimet që i bëhen këtij neni janë shumë specifike dhe asnjëri nga ne nuk është specialist i fushës. Kështu që mendoj që ato pak propozime që dolën nga ne, t’ia kalojmë komisionit përgjegjës dhe ta tejkalojmë këtë nen, duke shkuar në nenet pasardhëse. Ne nuk jemi specialistë për të dhënë një mendim të specializuar. Diskutimi që bëjmë ne në këtë komision ka të bëjë me nenet që vijnë pas për fushat që mbulojmë. Kështu që propozoj ta kalojmë këtë nen kështu siç është i shënuar dhe diskutimet përkatëse të bëhen si në Komisionin e Ligjeve, si dhe në Komisionin e Shëndetësisë.

Kujtim Gjuzi – Me leje, kryetar!

Ndoshta do ta quaj replikë ndërhyrjen time me kolegun e nderuar, e thamë edhe një herë tjetër, këtu kemi mbrojtësin e shtetit, mbrojtësin e qytetarit, në krahun tjetër kemi elitën tonë që po na ikën dhe për këtë duhet të jemi të kujdesshëm.

Shkëlqesi, Prokuror, keni një formulim tuajin të fundit?

Niko Peleshi –Siç e tha zoti Pëllumbi, ne po diskutojmë për disa nocione që në fakt nuk u dalim dot në krye, sepse janë dy komisionet përgjegjëse ato që e kanë trajtuar gjerësisht dhe, në fund të fundit, u takon atyre të japin mendimin përfundimtar.

Të gjitha mendimet tuaja janë të vyera dhe unë propozoj që te ky nen të mos propozojmë ndryshime të specifikuara, por në relacionin shoqërues të përmendim të gjithë frymën e diskutimeve që u zhvilluan në këtë komision, që nga rishikimi i termit të ndryshimit të masës, ose le të themi një kujdes më i mirë për masën e dënimit.

Patëm opinione kontradiktore, por ne nuk mund ta ndajmë dot, sepse, në fund të fundit, legjislacioni duhet parë në harmoni. Ne do ta vendosim në relacion edhe mendimin e zotit Gjuzi, për zbutje, edhe mendimin e zotit Shtjefni, për forcim të masave ndëshkimore.

(Diskutim pa mikrofon)

Zef Shtjefni - ...pastaj ata të bëjnë detyrën, sepse mjeku sheh punën e vetë, atje vdes pacienti dhe, kur vjen puna, përgjegjësinë nuk e mban askush.

Niko Peleshi – E kuptuam, zoti Shtjefni! Do ta përcjellim edhe mendimin tuaj.

Kujtim Gjuzi - Kryetar, e fundit.

Do të doja të bëja një lloj replike, se s'mund ta lëmë aq kollaj. Ti do t'i dalësh në mbrojtje prokurorit, se je jurist, e dimë, por edhe ti ke konflikt në këtë rast, apo jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë mirë bën që e mbron prokurorin, se je jurist.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni qejf t'i burgosni të gjithë njerëzit! Ne të tjerët kemi qejf që njerëzit të ndërgjegjësohen, të bëjnë punë më të mira, si pasojë e pagesës, që e the në fund...

Kujtim Gjuzi - Ky gabim ka që nga koha e Eurodotit. Kush e ka gabim tani, ju, apo unë? E gjeni dot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si i bie, është më mirë të vdes unë, se sa të burgosësh njerëzit që duhet të kurojnë të tjerët.

Ilir Beqaj – Duhet të mbajmë parasysh një gjë, që është pjesë e stadi të ulët të zhvillimit tonë. Në momentin që do të kemi takat të fusim sigurimin e profesionit të mjekut, bota i ka zgjidhur këto punë me sigurim profesioni, aty pastaj fillojnë historitë. Ne nuk mund t'i themi mjekut që ka një rrogë në sistemin publik, “shko bëj sigurimin e profesionit”, kur ta bëjmë

sigurimin e profesionit, në një mënyrë ose në një tjetër, atëherë të gjithë këto punë bota e zhvilluar ndaj i ka spostuar nga pjesa penale në....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rrezikun e gabimit bota e mbron me sigurimin e profesionit, ndaj edhe sot mjekësia kushton, sepse zanati i mjekësisë është i kushtueshëm. Po t'i shohësh sot të gjithë ata që punojnë si gjinekologë, paguhen shumë, të faturojnë shumë, sepse sigurimi i gabimit që mund të bëjnë, u kushton shumë.

Niko Peleshi –Do ta lëmë siç thamë, pra.

Ardit konomi – Po lexoja definicionet e pakujdesisë dhe neglizhencës së gabimit mjekësor dhe po shoh që janë të ndarë dhe janë vetëpërfshijëse në disa raste. Për shembull, gabimi mjekësor kupton të gjitha veprimet e gabuara të mjekut ose personelit mjekësor gjatë ushtrimit të profesionit, të kryera në mirëbesim dhe që nuk përmbajnë elemente pakujdesie. Këto përjashtojnë njëra-tjetrën, në fakt, dhe ndoshta është mirë të thuhet që neglizhenca dhe pakujdesia...

Ose ndarja e gabimit mjekësor të bëhet që këtu.

(Diskutim pa mikrofon)

Niko Peleshi – Jeni dakord që ne ta miratojmë nenin me shënimet dhe komentet në relacion duke i përfshirë të gjitha mendimet tuaja? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2 me vërejtjet që thamë, që të përfshihen në relacion të gjitha komentet e anëtarëve të komisionit, të grupuara, natyrisht.

Kalojmë te neni 3, i cili i referohet nenit 149 të Kodit Penal. Pas nenit 149/b, shtohet neni 149/c me këtë përmbajtje: “Shkelja e të drejtave të autorit, shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime të tërthorta apo të drejtpërdrejta përfitimi i veprës së mbrojtur nga autori pa pëlqimin e autorit ose e mbajtësit të së drejtës, përbën kundërvajtje penale ose dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”.

Nuk kam komente apo sugjerime të regjistruara.

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Unë do të sugjeroja që “komunikimi në publik” të hiqet. Pse? Po marrim një rast shumë njerëzor: një këngë mund të jetë e mbrojtur dhe unë nuk e di. Në një dasmë dikush

mund të thotë: “A ta marrim këtë këngë, shqiptare apo të huaj”, ndërsa po ta shpërndash, ta shesësh po bën një veprim... kurse komunikimi në publik është një gjë që ndodh...

Nuk e di çfarë ka dashur të thotë Ministria e Drejtësisë kur ka pasur parsysh “komunikimin publik”. Çfarë është konkretisht “komunikimi publik”?

Esmeralda Velaj – Lidhur me këtë nen, nuk kemi paraqitur komente, sepse e kemi pasur...

E kemi pasur te mjekimi i pakujdesshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – Unë mendoj se nuk është ky qëllimi, që transmetove një këngë në një dasmë dhe penalizohesh. “Komunikimi publik” ka kuptim mendoj, kur bëhet me qëllim fitimi, ndaj thuhet: “...pas kësaj shitja, ofrimi për shitje, furnizimi”, më duket formulim korrekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Më falni!

Nëse do të ishte më e qartë që fundi i fjalisë: “Për qëllime të tërthorta apo të drejta përfitimi” i përfshin të gjitha jo vetëm eksportimin ose importimin. Besoj se jemi në rregull. Pra, të bëhet një riformulim për fjalinë e parë. I përfshin, por është e interpretueshme, pasi kështu duket sikur përfshin vetëm eksportimin apo importimin.

Nëse ju jeni dakord, në rregull. A ka ndonjë mendim tjetër?

Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Vazhdoj të këmbëngul, ndoshta jam në minorancë, por t’i zbusim dënimet, sepse janë të ashpra. A do të shkojmë në Europë apo në diktaturë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Edhe unë te kjo pikë jam pak më tepër për dënime të zbutura, sidomos për uljen e viteve të burgimit edhe për efekt të të drejtave të njeriut, por edhe për faktin se për shtetin është goxha kosto sociale, ekonomike, janë shpenzime pa fund për t’i mbajtur njerëzit nëpër burgje. Mendoj se gjrobat mund të jenë të larta dhe burgimet mund të jenë simbolike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - Ku specifikohet?

Ilir Beqaj - Gjoba është e përcaktuar me minimumin dhe me maksimumin në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal.

Artan Syziu - Kur është kundërvajtje penale është më pak, kur është krim është më shumë.

Niko Peleshi - Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Këtu ka hapësirë për prokurorë, gjyqtarë dhe sistem të drejtësisë të korruptuar, prandaj duhet një gjë fikse, që të mos lëvizë askush.

Halit Valteri - Jam dakord, nga 3 vjet në 2 vjet. Vetëm në këtë formë edukohen njerëzit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e përcaktuar.

Niko Peleshi – A ka ndonjë mendim tjetër?

Kujtim Gjuzi – Siç tha edhe kolegja Gjermani, kostoja për një të burgosur, po t'i fusim në burg, nga taksat tona do të paguhet.

Jam dakord me zotin Beqaj, kur thotë që më mirë të ashpërsojmë dëmin ekonomik, se nuk ka dënim më të madh sesa ta detyrosh tjetrin të paguajë, se ai për çështje përfitimi po e bën këtë gjë. Nëse është 500 mijë lekë të vjetër deri në 3 milionë, e bëjmë 5 milionë, 10 milionë lekë. Nuk është e thënë t'i marrësh shtëpinë, ai të gjithë jetën do të detyrohet të punojë dhe të të paguajë ty për dëmin që ka bërë. Ndërsa kështu ai shkon bën 1 vit burg, me televizor, me telefon, me internet, me të ngrënë dhe të pirë me *katering*, me të gjitha të mirat dhe në fund paguajmë ne. Ai e bën përsëri, se pushim është, bukë pa lekë. Duhet të hiqet burgu dhe të futet 10 milionë lekë të vjetër gjobë.

Niko Peleshi – Kush është dakord me miratimin e këtij neni?

Masa e dënimeve duhet të shikohet pak edhe në mënyrë relative duke e krahasuar me dënimet e tjera. Nuk mund t'u vëmë ne gishtin. Nuk mund të dënohet me burg 3 vjet kush shkel të drejtën e autorit dhe me gjobë dikush që bën një faj më të rëndë. Mesa shikoj, unë i bashkohem frymës, që të zbutet masa e dënimit. Në fund të fundit na intereson si Komision për Veprimtaritë Prodhuese që të ketë aktivitet, të mos e trembim kapitalin. Ka ardhur koha që e drejta e autorit, shkelja e saj, të konsiderohet një lloj vjedhjeje.

Nga ana tjetër nëse ne nuk marrim masa për të mbrojtur krijimtarinë, krijuesit, do të thotë që shpirtin krijues e demoralizojmë. Prandaj të gjithë në parim nuk jemi kundër, por me

rekomandimin që të rishikohet masa. Komisioni i Ligjeve le ta vendosë masën në harmoni edhe me ndryshimet e tjera të Kodit Penal apo me legjislacionin në përgjithësi. Jemi dakord?

Kujtim Gjuzi - Jemi për zbutje?

Niko Peleshi - Do ta miratojmë siç është, por në relacion do të vendosim rekomandimin tonë për zbutjen e masës së dënimit.

Kujtim Gjuzi - Kishte dy propozime një nga kolegu im Beqaj. Nga ana tjetër, ana financiare të rritet. Ne ekonomistët kemi një konflikt interesi, sepse duam që të inkasojmë sa më shumë para te gjobat, që shkojnë në drejtim dhe në favor të qeverisë, të shtetit apo kujt do qoftë. Ndërkohë qytetari merr ngarkesa, e gjithë familja për një penaltet, për shembull muzikor.

Ju kërkojë ndjesë që po e marr shumë herë fjalën për këto vepra penale që ne i konsiderojmë të thjeshta. Sidomos për kundërvajtjet penale, pavarësisht se janë të shkruara në Kod, nuk ka pothuajse asnjë rast që të dënohen personat me burg, sepse ka dënim alternativ. Për dënimet deri në 5 vjet burgim aplikohet deri 90-95 për qind të rasteve dënimi me kusht, shkon te Shërbimi i Provës një herë në muaj, por duhet ta vuajë këtë dënim, që po e përsëriti apo po e shkeli provën, atëherë ai shkon në burg. Nuk ka asnjë rast në Shqipëri që për kundërvajtjet përjashtojë përsëritësit, të ketë...

Niko Peleshi - Kam përshtypjen se zoti Gjuzi po thoshte se kur këto masa janë shumë të forta prodhojnë biznes diku tjetër.

Artan Syziu - Meqenëse është merak për dënimet me gjobë, më falni, por po e lexoj: “Për personat që kryejnë krim gjoba është nga 100 mijë deri në 10 milionë lekë”. Paragrafi i dytë i kësaj dispozite. “Për personat që kryejnë kundërvajtje penale gjoba jepet nga 50 mijë deri në 30 milionë lekë”. Janë për të gjitha dispozitat, sepse nuk mund të vendoset gjobë e veçantë për dispozita të veçanta.

Kujtim Gjuzi - Pra, menjëherë qytetari kalon në një penaltet më të rëndë, 30 milionë lekë do të vijë ta marrë shtëpinë zyra përmbartimore pasi ju ta çoni në gjykatë, kjo e fundit të vendosë në tri shkallët e saj vendimin e formës së prerë. Shoqëria shqiptare ka probleme në lidhje me këtë. 23-33 për qind e shoqërisë shqiptare në këto momente është e penalizuar. Ne si deputetë që kemi ardhur për të ruajtur Republikën e Shqipërisë, e ruani edhe ju, zoti prokuror përmes ligjit më shumë sesa ne, por ne duhet të jemi të kujdesshëm në vendimmarrjen tonë.

Prandaj ju kërkoj edhe një herë që ta mbroni ligjin, por ta shikoni në frymën e një zhvillimi të ri që pret qytetari shqiptar.

Ju lutem, zoti prokuror, 30 milionë lekë të rinj, të vjetër apo si, i bie që ai qytetari do të vijë te ju dhe të thotë: “Unë do të bëhem hajdut, do të vjedh bankën”. Më kuptoni? Ju përsëri e keni në dorë, por përsëri ka korrupsion, sepse rrogat i keni të vogla. Po të ishin rrogat 5 mijë euro e sipër do të kishit më pak korrupsion. E kuptoni ku jeni? Jeni në veting.

Niko Peleshi – Të mos zgjatemi në një pjesë që i takon më tepër Komisionit të Ligjeve. Propozoj që ta miratojmë këtë nen siç është duke përfshirë në relacion mendimet e të gjithë anëtarëve, të cilat pak a shumë janë në një frymë, por ju siguroj se shërbimet e komisionit do t’i vendosin në relacion të gjitha propozimet tuaja. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 u referohet ndryshimeve për nenin 197 si më poshtë: “Organizimi i lojërave të palejuara”. “Organizmi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga 1-3 vjet. Po kjo vepër dënohet me burgim nga 2-5 vjet nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik dënimi me burg shtohet me një të katërtën. Pjesëmarrja në lojërat e fatit që zhvillohen në kundërshtim me ligjin, dënohet me gjobë ose me burg deri në 1 vit”.

Zoti Valteri.

Halit Valteri – Ne vijmë pas një vendimi të qeverisë që ndaloi aktivitetin e lojërave të fatit, i cili për mendimin tim, ishte një nga dështimet më të mëdha, sepse krijoi një gropë shumë të madhe ekonomike në buxhetin e shtetit. Sot lulëzojnë vendet ku ushtrohet aktivitet bixhozi në mënyrë të paligjshme, në çdo cep, në çdo kafe, në çdo loto ka nga një *smartphone*. Është shumë e lehtë për ta gjetur, për ta verifikuar, ka kompani të cilat janë të regjistruara *online* dhe kanë *user-a* dhe shpërndajnë me anë të *smartphone-ve* dhe lotot janë prezent në çdo cep të kryeqytetit dhe në çdo cep të Shqipërisë. Ky ligj duhet të forcohet ndryshe. Në fillim duhet moslejimi i kompanive, sepse është AKSH-i, ka institucione që mund ta parandalojë këtë gjë dhe jo të merremi me personat që luajnë, që ushtrojnë aktivitetin e bixhozit, apo të kumarit.

Kemi edhe rastin e lëndëve narkotike. Më falni, nëse gaboj, zoti prokuror. Për një sasi të caktuar nuk është se merren me përdoruesin e lëndëve narkotike, por merren me atë që e

shpërndan dhe e prodhon lëndën narkotike. Atëherë, si mund të merremi, për shembull me një djalë 17-18 vjeç që dikur luante me biletë të kafja e lagjes, ndërsa tani ekzistojnë aplikacionet, nuk e ka me biletë, por me *WhatsApp* i vjen bileta? Pra, ka qindra raste që po shikojmë përditë. Mund të ngrihet një komision hetimor që ta shikojë dhe ta verifikojë këtë rast. Ky nen duhet të shfuqizohet.

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj - Unë përtej nenit, dua të them dy gjëra. Kolegu që sapo dha opinionin e tij bëri një vlerësim të përgjithshëm dhe unë nuk ndaj të njëjtin vlerësim, sepse të paktën disa fakte flasin ndryshe, qoftë spostimi i konsumit në qytete të ndryshme, qoftë të dhënat që vijnë nga rritja e porosive për orendi mjedisesh arkëtimi apo tregtare, qoftë fakti që deri në fund të muajit shkurt sipas të dhënave zyrtare, të gjithë ata persona që deri në fund të dhjetorit punonin ligjërisht në lojërat e fatit, në fund të muajit shkurt, se nuk kam të dhënat e tjera, 60% e tyre kishin filluar punë në aktivitete të tjera. Pra, i njëjti person që ishte në një bordero deri në fund të dhjetorit, në fund të shkurtit 60% e tyre u spostuan. Po flas për ata që kishin punë të ligjshme.

Tjetra, praktikisht për saktësim është AKEP-i ai që mund ta bëjë bllokimin dhe jo AKSH-i, sepse AKEP-i është në gjendje që të kontrollojë të gjithë komunikimin elektronik dhe *online*. Kjo për saktësi, po nuk ka rëndësi, sepse edhe ai institucion shtetëror është. Në fund të fundit, thelbi është i njëjtë.

Unë dua të them një gjë konkrete: të gjitha gratë e Bulqizës janë të kënaqura, sepse u shkon e gjithë rroga në shtëpi dhe jo treçereku i rrogës siç u ndodhte deri në dhjetor. Në kohën kur ato ishin të ligjshme kompania që transferonte paratë kesh nga qytete të ndryshme në Tiranë, punën më të madhe e bënte nga Bulqiza. Ata dilnin nga galeria dhe shkonin në loto. Për fat të keq ne ende nuk u krijojmë mundësi të plota njerëzve që në Bulqizë të kenë çfarë të bëjnë edhe kur të dalin nga puna, por nuk mund të them se ajo nismë është e dështuar, përkundrazi është pozitive, edhe efektet deri tani janë pozitive. Ata që humbën interesat ekonomike do të tentojnë t'i spostojnë. Është folur se edhe një pjesë i kanë spostuar në Kosovë, por tani edhe Kosova po i mbyll. Në Mal të Zi kanë ekzistuar bixhozxhinjtë e mëdhenj. Problemi është se ata që shkojnë në Mal të Zi vijnë me avion edhe nga Europa. Këtu u bë aq kapilare sa ishte në çdo lagje dhe në çdo mëhallë. Nuk bëhet fjalë për ata që luajnë shumë, por për çdo njeri që lekët e shtëpisë, i merrte dhe i çonte aty. Kjo është pasqyruar veç të tjerave edhe në gjykatën shqiptare, ku bëhet raporti vjetor i vendimeve gjyqësore, grupi i divorceve si pasojë e kësaj

krize sociale vinte gjithmonë nga viti në vit në rritje. Ende është shpejtë për të thënë, nëse janë pakësuar divorcet për këta 5 muaj, sepse statistikat e këtij viti do të dalin në pranverën e ardhshme.

Niko Peleshi - Po, zoti Valteri.

Halit Valteri - Jam dakord me zotin Beqaj, por këto shifrat nga shkurti deri në dhjetor, nuk e di sa 60-70% e atyre punonjësve që janë punësuar, po e marr të mirëqenë, por nga loto ato janë bërë kafe, në shërbim të këtyre lotove. Është e njëjta gjë. Po të shkosh, jo ne se ne na njohin, por të dërgosh njerëz ose prokurorë në çdo dyqan. Unë banoj te ish- Parku i Autobuzave 1 në 5 kafe i ka me tablete në dorë, mund të futesh dhe të luash kumar shumë kollaj. Mund të vendosësh loto, ke edhe makineta. Nuk e di se çfarë bëjnë organet ligjzbatuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po them për gjë tjetër në këtë ne. Sot që flasim nen, është neni. Nëse prokurorit i vjen dikush që është kapur duke luajtur kumar apo duke organizuar një tavolinë Texas-i apo një lojë të paligjshme, a dënohet njëloj edhe pa u miratuar kjo?

Nëse sot të vjen dikush, gjoja të sjell Halitin që ka organizuar lojëra të paligjshme, njëloj dënohesh edhe pa e miratuar këtë ligj, ndoshta edhe më fort. Këtu e kemi 1 vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse i gjithë ky dëm ekonomik me miliona euro që i është bërë buxhetit të shtetit, është bërë për të bërë të lumtura gratë e Bulqizës...

E kisha për gjë tjetër dhe jo vetëm. Kjo është më e gjerë, sepse duhet të merremi më shumë me këtë temë, se sa t'i mbyllim gojën njëri-tjetrit, që bëjnë të lumtura ca gra në Bulqizë ose që bëjnë të lumtura ca gra në Tiranë. Nuk është ideja kështu. Nuk mund ta trajtojmë kështu një komision.

Faleminderit!

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, e kisha fjalën, po për respekt të zonjës Gjermani...

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Tani, unë nuk dua që të marrë konotacion negativ kjo pjesë, por jam dakord me kolegun Beqaj, për sa i përket impaktit pozitiv të ligjit të kaluar, të cilin e kemi miratuar me kolegët në parlament, në lidhje me organizimin e lojërave të fatit. Pikërisht për të përforcuar mënyrën se si zbatohet ligji, si respektohet, ky ndryshim i Kodit Penal vjen në ndihmë, duke penalizuar organizimet e jashtëligjshme. Është e vërtetë se kanë pasur ndikime

pozitive, por kini parasysh se jo vetëm te gratë, por te gjitha familjet shqiptare, edhe te fëmijët tanë, të cilët rriten me modelet negative të bixhozit e të lojërave të fatit. Po çfarë po bëjmë ne për ta ndërgjegjësuar opinionin publik, për të ndërgjegjësuar politikëbërësit, vendimmarrësit, sistemin e drejtësisë, për të respektuar këtë ligj, për ta zbatuar, si dhe për të penalizuar ata që nuk e zbatojnë.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi shumë ligje të mira. Jo gjithmonë kemi maksimumin e zbatimit të tyre, për shumë faktorë socialë, kulturorë, historikë, ekonomikë, por kjo nuk do të thotë se ligji nuk ka pasur impakt pozitiv, jo vetëm në Bulqizë, dhe e theksoj: jo vetëm te gratë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Në lidhje me këtë, më vjen në mendje koha e diktaturës, kur një nga komshinjtë e mi që dënuar me trembëdhjetë vjet burg, ngaqë luante bixhoz. Bixhoz, u tha atëherë. I biem shkurt, sepse e dini të gjithë se bixhë është ai fanti. Në fakt, çfarë të bëjnë shqiptarët kur s’kanë punë? Do të luajnë bixhoz.

Një gjë mund të rregullohej më mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë! Ju, qeveria juaj, keni jashtë bankës një tjetër buxhet. Tani po, të vjen çudi. Mos të të vijë çudi! Ke edhe 45 miliardë euro të inkasuara në bankat jashtë. Do t’jua sjellim informacionet pak më vonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërprit, të lutem!

Zoti kryetar, mbaj qëndrim ndaj kolegut!

Faleminderit!

Pra, në këtë rast, ka njerëz pranë qeverisë, që nuk kontrollohen nga sistemi tatimor. Nuk them se fijet shkojnë deri te Kryeministri, se nuk e kam ende këtë konstatim, por njerëz pranë qeverisë kanë lojërat e tyre, ashtu si dhe ndokush tjetër te qeveria e kaluar. S’kam frikë ta them fare. Në raste të tjera do të ketë edhe emra, por jo tashti, sepse kemi zotin prokuror këtu, i cili mund ta marrë si provë këtë, e të më thotë: hajde zoti Gjuzi e më jep provat!

Nëse oficerët e Policisë Gjyqësore do të dalin në terren, që të shohin, ata do të arrijnë në konkluzionin se lojëra fati, tashmë në paligjshmëri, do të marrin dënime. E mua më vjen keq,

edhe kur janë pranë qeverisë, që t'i burgosim tre vjet, pesë vjet. Sepse të gjithë do t'i burgosim, por ku ka aq shumë burgje? Na duhet të investojmë në burgje. Ndërkohë, të investojmë që t'i nxjerrim njerëzit nga burgjet, t'i ndërgjegjësojmë dhe t'u themi: ju do t'i riktheheni punës.

A ka bërë ky komision aq punë? Nuk e di. Ndoshta ishit në konflikt të madh me ata kolegët tanë që ikën, që dolën dhe zgjodhën rrugën. Tani keni përballë disa kolegë të tjerë, të cilët mendojnë më shumë për qytetarin. Kështu mendojmë ne. Prandaj, shkëlqesi Prokuror, do t'ju lutesha, që të formuloni një propozim tuajin, gjë që besoj se do të ishte interesante.

Faleminderit, zoti kryetar!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Ka ndonjë mendim tjetër?

Zoti Konomi.

Ardit Konomi – Unë mendoj se domosdoshmëria e këtij ligji nuk duhet vënë në diskutim. Në fakt, edhe sikur të jetë realiteti që përmend zoti Valteri, prapë ligji qëndron, nuk shkon kundra tij.

Teknikisht, te pjesa e parë, pjesa për organizimin, unë do të sugjeroja të mos përjashtohet gjoba. Nuk e di se si përkthehet pastaj në terma juridike, por kjo pjesë të jetë ekuivalente me dëmin e shkaktuar, ose të ketë një masë të përcaktuar, pak a shumë sipas logjikës së zotit Beqaj, të mos jetë diapazon i gjerë, nga aq deri kaq. Gjoba duhet të jetë.

Artan Syziu – Ne i kemi dhënë sugjerimet tona me shkrim. Për teknikë legislative, ne mendojmë se këto fjalitë nuk duhet të jenë njëra pas tjetrës, por duhet të jenë paragraf më vete.

Sa i takon sugjerimit të bërë nga parafolësi, që mund të parashikohet gjobë, mendoj se është një sugjerim i pranueshëm në paragrafin e parë, por në rast se do të vendoset gjobë, duhet të hiqet ai dënimi minimal me burgim, sepse është e papranueshme të dënohet me gjobë e pastaj të fillojë direkt një vit burgim. Pra, me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, do të ishte korrekte.

Niko Peleshi – Atëherë, propozoj të procedojmë si me nenet e kaluara, pasi i kemi dhënë të gjitha propozimet tona, opinionet, komentet; t'i përfshijmë në relacion dhe ta miratojmë nenin, sepse nuk marrim dot përsipër të vendosim afate apo masa dënimesh. S'është detyra jonë.

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, më leje!

Niko Peleshi – Urdhëro, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Dua ta falënderoj pa masë shkëlqesinë e tij, zotin prokuror, që është këtu dhe që u tërhoq nga kërkesa e dënimit. Pra, të mos kthehemi në diktaturë, kur thuhej: do të të fusim në burg, sepse bërë këtë punë, por ne do të të gjobisim njëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dale, se e hoqi tani në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valter, isha me ty!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por e riformuloi frazën. Shiko përtej frazës, kërko përtej frazës, Valter!

Nëse qeveria dhe pjesa përballë, pjesa e pozitës, kërkon ta rëndojë, ne jemi opozita dhe duhet ta lehtësojmë, dhe le të dakordësohemi të gjithë se duke lehtësuar edukojmë. Të edukojmë është më mirë se sa të dënojmë. Po ta shkojmë prapë te fryma e ligjit: duke dënuar do të harxhojmë 155 euro në ditë për një të ndaluar, i cili vuan dënimin. Këtë e mësova në burgun e Fushë-Krujës, ku isha para katër-pesë ditësh. Aty kishte njerëz të dënuar për gjëra absurde. I pyeta: kur te dilni, do të vini prapë këtu? E dini çfarë thanë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkova ta provoja si e merrnin ushqimin, se më thanë se ka korrupsion në ushqim. Shkova dhe e provova ushqimin. Ushqimi ishte shumë i mirë, si në shtëpinë time ishte. Edhe më i mirë madje. Patjetër, diçka që qeveria e ka bërë mirë, pse të mos e them? S’kam turp ta them fare. Unë them të vërtetën. Prandaj, nga zoti prokuror, të cilin e falënderoj shumë për këtë komunikim që bëmë së bashku, kërkoj që të ngremë një frymë tjetër.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Baraj.

Besnik Baraj – Do të doja të thosha komplimente për zotin Gjuzi. Vërtet që ëmë pëlqen diskutimi në mënyrë parimore. Në çdo fushë të jetës, profilaksia është shumë më me vlerë se sa kurimi më pas. Edhe në këtë sektor.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

E mora fjalën për të bërë pak replikë me zotin Gjuzi, vetëm në një aspekt, në lidhje me atë që thotë, se maxhoranca e ka si tendencë të rëndojë, ndërsa ne të opozitës e kemi si tendencë të lehtësojmë.

Kjo nuk është e vërtetë. Unë nuk jam dakord me ju. E gjithë fryma e këtyre ndryshimeve ligjore që po bëjmë, është frymë që synon të lehtësojë dënimet penale, por sigurisht, ka edhe vende ku, për efekt të situatave që na kanë ndodhur, mund të kemi edhe ndryshime me tendencë forcimin e dënimit.

Gjithsesi, ju e shikoni se ne jemi plotësisht të hapur për të diskutuar, për se këtë arsye jemi këtu, ndaj nuk mund ta vini në diskutim qëllimin e maxhorancës për të lehtësuar dënimet penale.

Kujtim Gjuzi – Replikë me kolegun.

E falënderoj që më referohet. E ritheksoj: jemi ligjvënës të gjithë këtu, kemi një lloj arsimit, ndoshta pak më shumë se pjesa më e madhe e shoqërisë, ndaj duhet të jemi të kujdesshëm. E dini si më tingëllon fjala bixhoz? Si fjala matrapaz, për shembull. Këto terma i kishte diktatura. A mund t'i largojmë pak këto terma? I kemi në fjalor, nuk është shkelje po t'i përdorim, por këtu jemi elitë: kemi prokurorin, kemi kryetarin, kemi kolegë juristë të ekonomisë. Kjo ishte. Por, që ju i rëndoni, i rëndoni. Edhe i kufizoni.

Doni t'ju jap ca emra? Se i kam gati emrat, po për sa kohë është prokurori, duhet të jemi të kujdesshëm sot, që ta trajtojmë në frymën e ligjit për të lehtësuar burgimet. Ju thashë: vi nga burg. Kam qenë në burg, te qelitë, atje brenda.

Faleminderit, i nderuar koleg!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'kam asgjë me ju, por ato që mendoj, i them.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Në fakt, këto ndryshime janë të domosdoshme, sepse nga njëra anë nuk lejohet ushtrimi i këtij aktiviteti, ndërsa nga ana tjetër, shkelja e këtij ligji nuk konsiderohet si vepër penale. Për këtë arsye, edhe zoti Valteri e tha me të drejtë, deri në pjesën që nuk e kemi fituar ende plotësisht betejën me këtë aktivitet, i cili për momentin, për stadin ku jemi, për nevojat që ka zhvillimi social e ekonomik në vendin tonë, ende nuk është e fituar si betejë. Kjo për shkak se ka informalitet. Ka informalitet, sepse sot konsiderohet thjesht kundërvajtje

administrative nëse shkel ligjin e ushtrimit të aktivitetit të lojërave të fatit. Prandaj, në parim është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

Tani, masa e dënimit ka diskutim. Nuk diskutohet se gjithkush ka të drejtë, Nuk ekziston një e drejtë absolute,

Pra, si thoni? Vazhdojmë me parimin që ndoqëm edhe për nenet e kaluara? I përfshijmë gjithë këto propozime. Këtu ka një maxhorancë opinionesh për ta zbutur, pra për ta zbutur në krahasim me vetveten, me propozimin, për ta ulur dënimin me burg. Ka edhe mendime të tjera nga kolegët, që thonë se është në rregull, se duhet shtrënguar, se duhet forcuar.

Qëllimi nuk është të fusim njerëz në burg dhe as të arkëtojmë gjoba.

Kujtim Gjuzi – Kryetar, ata që kërkonin shtrëngimin ishin me pakicë.

Niko Peleshi – E thashë. Qëllimi është t'i mbajmë sa më larg këtij aktiviteti. Pra, as të mos dënohen, as të mos gjobiten, por të mos merren fare me këtë gjë. Këtë qëllim ka ligji.

Kujtim Gjuzi – A mundem ët them diçka të fundit, kryetar?

Niko Peleshi – Po, të lutem!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Që ta shikojmë më mirë këtë, le t'i referohemi fqinjët tonë veriperëndimor, Malit të Zi. Mali i Zi i ka mbledhur në disa qendra. Ne nuk e aplikuar këtë, sepse duam ta kontrollojmë në Tiranë çdo gjë, çdo financë duhet të dalë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I nderuar koleg, nuk të kam ndërprerë ndonjëherë! Mos më ndërprit, të lutem! Ki durim!

Le t'i referohemi një gjëje, meqë jemi këtu, te Komisioni i Veprimtarive: që financa duhet të vijë në shtetin shqiptar përmes sistemit të taksapagimit. Po shikoni pak, kemi një kala atje poshtë, kalaja e Ali Pashë Tepelenës. Nuk i ka shkuar askujt ndërmend, përveç një ekonomisti, të cilit s'dua t'i përmend emrin, që tha: po sikur ta bëjmë atje një qendër kazinoje? Do të vinte e gjithë bota të luante. Pra, ta shohim në këtë frymë. Po t'i burgosim të gjithë, do të thonë: çfarë të bëjnë në Shqipëri për këtë lojë? Të burgosin. E dini çfarë do të thotë kjo apo jo? S'ka prurje financiare.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi, besoj jeni i informuar se edhe këtu te ne, në hotelet me pesë yje, në qendrat e mëdha, në zonat turistike, këto aktivitete lejohen, pra aktivitetet e përqendruara në zonat turistike, në kushte të caktuara dhe me disa kritere të përcaktuara, që padyshim

përfshijnë edhe kriterin financiar, taksën e lartë e kështu me radhë, por që nga ana tjetër i bëjnë edhe atraktive për turistët.

Çështja është se këtu te ne, ky fenomen ishte i përhapur gjithandej. Ishte në çdo qoshe, në çdo lagje, kishte deformuar tregun e pasurive të patundshme, kishte rritur në mënyrë fiktive çmimet e qirasë të ambienteve në qendrat e qyteteve. Qendrat e qyteteve ishin pushtuar nga aktivitetet e lojërave të fatit. Nga pikëpamja ligjore s'kishte ndonjë gjë të keqe, sepse ishin të lejuara, por nga pikëpamja sociale ishin një dramë e madhe.

Dua ta kundërshtoj pak zotin Pëllumbi, ose më mirë të them kam një mendim ndryshe nga ajo që tha, se aty ku ka papunësi s'ka si të ketë kumar. Në fakt, fatkeqësisht, është e kundërta. Sa më shumë varfëri të ketë, sa më periferik të jetë një qytet, aq më shumë jepen njerëzit pas këtyre aktiviteteve.

Prandaj, sidomos për këto zona, sidomos për zonat periferike, qytezat e vogla dhe fshatrat, ky ishte një shpëtim i madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bulqizën solli si shembull.

Kujtim Gjuzi – Është vendi i prodhimit të floririt atje, prandaj. Edhe të një floriri tjetër me ngjyrë jeshile.

Niko Peleshi – Kështu që, për stadin në të cilin jemi, efektet që dha janë shumë të mira, shumë pozitive. Në qendrat e qyteteve po shohim ca aktivitete të tjera shërbimesh, të cilat deri dje nuk hapeshin dot, ngaqë nuk i përballonin dot qiratë, që ishin të larta fiktivisht. Një pikë bastesh mund të paguante një qira shumë të lartë, por një butik, po themi, një agjenci turistike nuk e përballonte dot një qira të tillë, ndaj nuk hapej fare. Tani ato janë hapur. Ka ndryshuar pamja e qyteteve. Natyrisht, mbase është një masë e përkohshme. Shpresojmë se do të vijë një moment tjetër, edhe i stadii tonë të zhvillimit social, mbi të gjitha, kur edhe lejimi i këtyre lojërave nuk do të jetë kaq problematik sa ç'na rezulton në këtë periudhë, po për momentin besoj se duhet ta mbështesim këtë nismë, edhe me këto ndryshime në Kodin Penal.

Në lidhje me masën, i kërkoj Shërbimeve të Komisionit, që t'i bashkëngjisin opinionet në relacion opinionet, edhe me dozën. Pra, në qoftë se këtu pati një dozë më të lartë të propozimeve për uljen e dënimit, le të bëhet e qartë në relacionin që do t'i dërgohet Komisionit të Ligjeve.

Procedojmë si me nenet e para.

Kush është dakord me nenin 4, bashkë me vërejtjet që thamë në relacion? Kundër? 1. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë në pikën 5. I referohet nenit 201 të Kodit Penal, i cili propozohet të ndryshohet si më poshtë: Ndotja e ajrit dhe e tokës.

“Ndotja e ajrit, ndotja në sipërfaqe apo në thellësinë e tokës, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes në përdorim të materialeve me rrezatim jonizues dhe radioaktiv, ose e lëndëve të tjera toksike, e bërë përtej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur është kryer në zonat e mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar dëme të pakthyeshme të ekosistemit, biodiversitetit, florës ose faunës, dënohen me burgim nga 1 deri në 5 vjet. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni ka shkaktuar plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga 1 deri në 7 vjet. Kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një ose disa personave dënohet me burgim nga 2 deri në 10 vjet. nëse ka shkaktuar vdekjen e një ose të disa personave dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.”

Zoti Baraj.

Besnik Baraj – Unë do të preferoja që kjo: “lëndëve të tjera toksike” të zëvendësohet me: “mbetje të rrezikshme”, meqenëse është një term më i përgjithshëm, tek i cili përfshihen lëndët toksike, por njëkohësisht edhe lëndët që nuk janë toksike, por që paraqesin rrezikshmëri për jetën e gjallë në përgjithësi, që mund të jenë lëndë plasëse, e të tjera.

Kështu që, propozoj të ndryshohet nga “toksike” në “mbetje të rrezikshme”.

Niko Peleshi – Një saktësim: në kolonën e fundit, dhe është mirë të diskutojmë mbi të, neni është riformuluar nga Ministria e Mjedisit dhe grupi i punës. Është shtuar edhe: “e ujërave”. Pra, “ndotja e ajrit dhe e tokës”, është bërë: “ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”.

Po e lexoj edhe një herë atëherë, po e lexoj shpejt nenin e riformuluar:

“Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave, ndotja në sipërfaqe apo në thellësinë e tokës, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sërë materialesh në ajër, tokë apo ujë, e bërë përtej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur është kryer në zonat e mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka

mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, florës ose faunës, dënohen me burg nga 1 deri në 5 vjet. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga 1 deri në 7 vjet. Kur kjo vepër shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë...”

Pra, vini re që tek të gjitha është shtuar:”ose ka mundësi të shkaktojë”!

“...plagosjen e rëndë të 1 ose disa personave, dënohet me burgim nga 2 deri në 10 vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë vdekjen e një ose të disa personave, dënohet me burgim nga 5 deri në 10 vjet.”

Besnik Baraj – Për të plotësuar këtu atë të Ministrisë së Mjedisit të ujërave si sipërfaqësorë, ashtu edhe nëntokësorë, siç janë lumenjtë, por fare mirë mund të ndotësh dhe të kontaminosh edhe ujërat nëntokësorë, që janë burime të ujërave të pijshëm.

Niko Peleshi - Fjalën e ka përfaqësuesja e Ministrisë së Mjedisit. Pastaj fjalën e ka zoti Gjuzi.

Klodiana Marikaj - Përshëndetje!

Jam Klodiana Marikaj, drejtore e Programeve të Zhvillimit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të krimit mjedisor në Kodin Penal! Pavarësisht të gjitha diskutimeve dhe bashkëpunimeve që ne kemi bërë edhe me përfaqësuesit e Kryeministrit, ku këto ditë kemi qenë edhe në Komisionin e Ligjeve, vihet re një ndryshim i terminologjisë së përdorur në nenin 201. Neni 201 ka qenë “çlirimi, shkarkimi, futja e materialeve, ose rrezatimi jonizues në mjedis”. Flas për përdorim të saktë të terminologjisë, sepse varianti që ne kemi prezantuar është në përputhje të plotë me direktivën për krimin mjedisor, ku të gjithë paragrafët, madje edhe presjet janë të sakta, pasi në procesin e *screen*-it ata i shikojnë edhe tabelat e përputhshmërisë dhe kapen fjalë pas fjale. Faktikisht, edhe te ndotja e ajrit dhe e tokës, edhe te çlirimi, shkarkimi, futja e materialeve ose rrezatimi jonizues në mjedis përmbajnë pak a shumë të njëjtat veprime, të cilat ndodhin ose mund të ndodhin në mjedis, të cilat kanë për qëllim shkatërrimin e cilësisë së mjedisit, duke pasur pasoja të rënda për shëndetin njerëzor. Ne i qëndrojmë strikt përdorimit të këtyre neneve, ashtu siç ne i kemi propozuar, me qëllim përputhshmërinë e plotë të direktivës së krimit mjedisor. Ndërsa për pjesët e tjera ne jemi dakord. Ideja nuk ka ndryshuar, por mënyra e renditjes së veprave që kanë ndodhur ose mund të ndodhin paraqiten ndryshe në direktivën për krimin mjedisor.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi futur materialet me rrezatim jonizues në mjedis, që është më i gjerë sesa pjesa toksike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Radioaktive është tjetër.

Besnik Baraj – Në qoftë se ju keni një zonë mbetjesh, që përmbajnë mërkur apo plumb, nuk kanë efekt jonizues dhe janë substanca shumë toksike, mbetje të rrezikshme. Në qoftë se ju thoni vetëm efekt jonizues, ju praktikisht e kufizoni shumë spektrin e lëndëve dhe fare mirë të vjen dikush dhe derdh materiale që përmbajnë metale të rënda, të cilat nuk janë jonizuese dhe janë mbetje e rrezikshme. Duke e kufizuar vetëm te “jonizues”, për mua është e limituar.

Klodiana Marikaj – Në këtë mënyrë e parashikon direktiva, por pjesën e substancave të rrezikshme citohet te pjesa e dispozitave, te menaxhimi i mbetjeve, por edhe në ligjin specifik.

Besnik Baraj – Unë nuk e shoh të arsyeshme që të jetë vetëm material jonizues. Materiale jonizuese ne mund të kemi të kufizuara në Shqipëri për shkak se në Shqipëri nuk ka aktivitete që kanë reaktorë atomikë, ose substanca radioaktive, të cilat janë të kufizuara ose në spitale ose në industri tepër të kufizuara, ndërsa substanca të tilla, që janë të rrezikshme për jetën e gjallë patjetër që duhet të përfshihen këtu, pavarësisht se direktiva nuk i ka përfshirë.

Niko Peleshi – A ka përkufizim për ato që quhen mbetje të rrezikshme?

Besnik Baraj – Po, sigurisht, ka në ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe i ka terminologjia se cilat quhen mbetje të rrezikshme.

Niko Peleshi – Varianti që unë lexova nuk është varianti juaj, i Ministrisë së Mjedisit dhe grupit të punës?

Klodiana Marikaj – Ne kemi dorëzuar një variant që e kemi bërë në përputhje me direktivën dhe është ripunuar...

Niko Peleshi – Nga kush?

Klodiana Marikaj – Nga kolegët e Kryeministrisë, është diskutuar edhe me EURALIUS-in, ku ka ndryshime të variantit fillestar nga ana jonë.

Niko Peleshi – Pra, ky nuk është varianti juaj?

Klodiana Marikaj – Jo.

Niko Peleshi – Xhilda, varianti i kujt është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi - Zoti kryetar, drejtoresha mund ta lexojë atë.

Niko Peleshi- Janë tri variante dhe mund të konfondohemi.

Kujtim Gjuzi – Le ta lexojë, sepse ne jemi vendimmarrësit.

Niko Peleshi – Sot kemi variantin që lexuam dhe deri tani kemi dy propozime nga zoti Baraj, i cili propozon që në vend të fjalës “ujëra” të shtojmë “ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore” dhe në vend të fjalës “toksike” të përdorim ...

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, ndoshta është hequr me qëllim.

Niko Peleshi – Varianti i ri është “e futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialeve në ajër, tokë ose ujë, e bërë tej kufirit të normave të lejuara me ligj”.

Niko Peleshi – Kjo krijon hapësira për mbetje të rrezikshme, që zoti Baraj përmendi.

Besnik Baraj – Dua t’u kujtoj të gjithë kolegëve këtu se në Shqipëri ne kemi shumë hotspote, që përmbajnë substanca toksike me pale të rëndë, pesticide, insekticide e të tjera, të cilat mund të merren aty dhe mund të derdhen në lumenj, që për mua është një veprim i dënueshëm. Prandaj, ndoshta në direktivën europiane u është përshtatur kushteve, standardeve dhe situatës historike që ata kanë. Ne kemi problematikë me substancat, të cilat, në mënyrë të vazhdueshme, kontaminojnë ujërat sipërfaqësore, tokën e të tjerë. Kështu që unë mendoj se duhet patjetër të futet kontaminimi i tokës dhe ujit nga substanca të rrezikshme. Kur thua: “substanca të rrezikshme”, aty përfshihet edhe lindani, edhe kabniumi, edhe kripërat e plumbit, edhe kripërat e merkurit. Për shembull, ne kemi në sodën e Vlorës, pavarësisht se është e inkapsuluar, por prapë ekziston ky rrezik, kemi në Porto Romano e të tjerë. Pra, të gjitha këto i përshtaten realitetit shqiptar dhe mendoj se këto duhet të përfshihen.

Niko Peleshi – Zoti Baraj, varianti që po shqyrtojmë, siç e kuptoj unë, ka ardhur nga grupi i punës, i parashikuar edhe nga EURALIUS-i, dhe mendoj se është akoma më i gjerë dhe më i ashpër se ky që propozoni ju. Ju propozoni përdorimin e substancave të rrezikshme, ndërsa këtu dënohet edhe përdorimi i materialeve tej kufirit të normave të lejuara. Pra, edhe një substancë e lejuar me ligj, në qoftë se përdoret tej kufirit të lejuar, dënohet me burg deri në tri vjet.

Besnik Baraj – Për mua është korrekte kjo. Nuk është e shpjeguar në formë eksplicite “mbetje të rrezikshme”, por sigurisht që çdo substancë, e cila është mbi atë që quhet *background* natyror ose fondin natyror, kur njeriu për arsye subjektive e rritë atë, për mua është korrekte.

Kujtim Gjuzi - Faleminderit, kryetar!

Kam një pyetje për drejtoreshën. Zonja drejtoreshë, a keni informacion se çfarë ndodhë me 36 gropat e zeza që ndodhen në Shqipëri?

Pyetja e dytë është: a ka informacion zoti prokuror lidhur me një deklaratë të bërë dy vjet më parë nga opozita në “Çadrën e lirisë” kur u tha se 1300 kontejnerët me mbetje të rrezikshme kanë kaluar përmes Shqipërisë, që në fakt ishin 2500, të cilat janë ndaluar në Shpirag dhe një pjesë tjetër në Përrenjas?

Në fakt, kam kohë që e kam pritur këtë takim dhe falënderoj kryetarin e komisionit dhe të gjithë ata dashamirës që kanë kërkuar ta ashpërsojmë ligjin. Nëse në pjesën e parë isha dakord për t’i zbutur ligjet, këtu jam në mënyrë eksplicite për ta ashpërsuar ligjin, në mënyrë që askush nga Europa të mos vijë këtu dhe të na trajtojë si tualet, nuk dua ta përdor këtë term, por jam i detyruar, në mënyrë që ne të jemi të kujdesshëm. Shkëlqesi prokuror, a mund ta merrni si indicie për të parë se çfarë është transportuar nga Bari në drejtim të portit të Durrësit pikërisht në periudhën shtator-tetor-nëntor të vitit 2016? A ka gjurmë në doganën e Durrësit?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi, faleminderit!

Pa shmangur shqetësimin që keni, por edhe për të mos dalë nga rendi i ditës së sotme, ju sugjeroj që këto çështje dhe çdo çështje tjetër që lidhet me mjedisin apo me legjislacionin përkatës t’i diskutojmë në një seancë dëgjimore.

Kujtim Gjuzi – Ju lutem, kryetar, e kisha për mbetjet e rrezikshme, edhe në mbështetje të asaj që tha zoti Baraj.

Niko Peleshi – Dakord, por e thashë që t’u japim mundësi edhe institucioneve të tjera të vijnë të raportojnë me përgjegjësi për çështjet që ju ngrini dhe t’i trajtojmë në një seancë të veçantë dëgjimore me ministrinë, ashtu siç kemi bërë edhe me institucionet e tjera.

Kujtim Gjuzi – Përfitoj nga rasti që kemi drejtoreshën këtu dhe dua edhe një përgjigje nga ajo dhe zoti prokuror ta marrë këtë nën këshillim, sepse në momentin që ky lajm u bë publik, nga opozita kishte heshtje. Ky informacion i detajuar më erdhi nga zyrat e policisë europiane, jua them me përgjegjësi të plotë këtë, kam pasur kontakt me oficerë të lartë të policisë europiane për këtë çështje. Është kënaqësi e jashtëzakonshme që këtë shqetësim ia them shkëlqesisë këtu, zotit prokuror, por nga drejtoresha dua një përgjigje në lidhje me 36 mbetjet radioaktive, që sillte këtu diktatura përmes Gjermanisë, prandaj ishte e gatshme që të kalonte hekurudha.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Unë propozoj që bashkë me Kujtimin të bëhemi iniciatorë të një dëgjese, e cila të jetë sa më e plotë dhe të ftojë mediet, grupet e interesit dhe ndonjë shoqatë.

Niko Peleshi - Gjithsesi, meqenëse zoti Gjuzi insiston për përgjigje, i kërkoj drejtoreshës që, nëse ka diçka që mund të na ndihmojë në optikën e diskutimeve për ligjin, jo jashtë teme, të na e thotë.

Klodiana Marikaj – Së pari, ne nuk kemi informacion për këto të dhëna që ju thoni, për mbetje të rrezikshme, por, në qoftë se ju keni një informacion të detajuar, mund të bëni një kallëzim në prokurori, sepse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk është organ prokurorie.

Për sa u takon mbetjeve të Shkodrës, unë, fatmirësisht, kam qenë 8 vjet menaxhere e programit të Kombeve të Bashkuara për menaxhimin e mbetjeve dhe kemi rehabilituar stacionin e Bajzës, i cili u konsiderua se kishte të bënte me mbetje radiokative dhe në fund doli natrium florës silikat. Megjithatë, të gjitha ato mbetjet janë transportuar për t'u incineruar në Angli dhe Holandë. Ky është një informacion i saktë dhe ju mund ta vërtetoni edhe me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri për të dhënat e të gjithë studimit lidhur me stacionin hekurudhor të Bajzës.

Për sa u takon mbetjeve të rrezikshme, që ju citoni, ne nuk kemi një informacion të tillë. Megjithatë, për të bërë transport mbetjesh të rrezikshme, ligjet dhe konventat, jo ato kombëtare, por ndërkombëtare, janë shumë strikte për ta bërë një gjë të tillë. Që të sjellësh një sasi mbetjesh të rrezikshme brenda një territori, ti kalon në hapësira portuale, toksore apo detare, ku duhet të jesh i pajisur me një konsten letër të të gjitha vijave kufitare. Në qoftë se kjo ngarkesë ka ardhur nga 10 vende dhe ne kemi qenë pritësi, i bie që 10 vende të Komunitetit Europian kanë shkelur të gjitha dispozitat ligjore për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Unë mendoj se citimi juaj nuk më duket i saktë.

Faleminderit!

Kujtim Gjuzi – E nderuar drejtoreshë, ju nuk keni informacion për 36 gropat e zeza që ka Shqipëria?! A mund të shkojmë në Durrës e të shohim se çfarë ndodh atje? A doni fakte?! Kurrë nuk flas pa pasur një informacion të detajuar dhe pa e parë në vend.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit

Vazhdojmë me diskutimin. Siç e thamë, ne kemi një instrument shumë të mirë dhe efikas për të bërë pyetje dhe për të marrë përgjigje për çështje që na interesojnë neve dhe publikut, që është dëgjesa me institucionet. Ashtu siç e tha edhe zoti Baraj, i cili është ekspert i fushës me ndjeshmëri shumë të lartë për mjedisin, bëhuni bashkë dhe menjëherë mund të zhvillojmë një dëgjese, natyrisht duke parashtruar edhe çështjet që ju interesojnë juve dhe atyre që përfaqësoni.

Fjalën e ka zoti Musaj.

Nimet Musaj – Faleminderit, kryetar!

I dëgjova shqetësimet e kolegëve. Unë vij nga qarku i Fierit, ku ka pasur dhe vazhdon të ketë prononcim për ngritjen e një landfilli në Verri, ku ka pasur edhe peticione të ndryshme. Dua t’ju falënderoj kryetarin e komisionit dhe kolegun Baraj për sugjerimin për një seancë tjetër dëgjimore që të sqarojmë qytetarët se gjithçka është brenda rregullave.

Faleminderit!

Ardit Ikonimi - Duke qëndruar te formulimi i grupit të punës, besoj se ka nevojë edhe për një saktësim, i cili lidhet me atë që përmendi zoti Baraj, për mbetjet e rrezikshme. Po ta lexoni në kontekst, kjo i referohet më shumë sasisë së mbetjeve se sa natyrës së tyre, ku thuhet: “ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë përtej kufirit të normave të lejuara me ligj...”. Po t’i shohim fjalët “tej kufirit”, ato i referohen sasisë dhe jo natyrës së materialeve. Prandaj sugjeroj të përcaktohet “materiale të rrezikshme”.

Niko Peleshi - Atëherë, duke e integruar edhe propozimin e zotit Ikonimi, mendoj se formulimi do të ishte: “Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues të substancave të rrezikshme, ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, e bërë tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Baraj tha që të mos përdoret fjala “toksike”, por “mbetje të rrezikshme”.

Besnik Baraj – Më tërhoqi vëmendjen kolegu parafolës. Niveli i substancave ndotëse në një zonë mund të jetë shumë i ulët dhe, sipas këtij ligji, në qoftë se ne themi kur janë mbi normat e lejuara, atëherë kjo do të thotë se ne mund të derdhim dhe mund të shkarkojmë aty, por pa kaluar nivelin maksimal të lejuar. Me këtë përkufizim ai mund të thotë që nuk e ka kaluar nivelin dhe veprimi nuk duhet penalizuar. Ndoshta termi “përtej nivelit të lejuar” është një tolerancë për zona që janë shumë të pastra dhe të pa kontaminuara, por pa kaluar nivelin.

Ndoshta ne duhet ta rishikojmë dhe të themi: “ndalohet hedhja e substancave të rrezikshme” pa përdorur “mbi nivelin lejuar”, sepse ashtu ne legjitimojmë shkarkimet deri në një nivel të caktuar, por, në qoftë se arrijmë në kufi, përsëri ajo ka impakt në cilësinë e ekosistemeve të ndryshme.

Niko Peleshi – Mendoj se formulimi im është më i saktë, sepse këtu bëhet fjalë edhe...

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, të lutem, na e lexoni edhe një herë, që ta kuptojmë më mirë!

(Mungesë regjistrimi)

Besnik Baraj – Kemi një zonë që nivelin e mërkurit, nivelin natyror e ka 5, kurse niveli i lejuar është 50. Atëherë, ai mund të hedhë deri në 45 ose 49,9? Pra, e dënon ligji një person, kur niveli natyror është 5 miligram për kilogram, kurse legjislacioni thotë që kjo zonë quhet e kontaminuar, kur është mbi 50 miligram për kilogram”? Pra, personi, subjekti shkon dhe e rrit, e mat me kujdes dhe shkon 49,5, që matjet analitike të jenë brenda një kufiri gabimi. Në këtë rast ky ligj e penalizon këtë person, që ka bërë këtë derdhje? Në qoftë se nuk e penalizon, patjetër që duhet të penalizohet ai njeri.

Niko Peleshi – Kufiri i lejuar nga ligji, për shembull 50, nuk është kot?!

Besnik Baraj – Ai lidhet me një mesatare të vlerave të gjetura në koren e tokës, por kjo mesatare është statistikore dhe në disa vende është më e lartë, për shembull, në zonat vullkanike, kurse në zona të tjera, që nuk kanë këtë lloj strukture, mund të jetë në nivele shumë të ulëta, por t’i duhet ta matësh. Pra, efekti antropogjenik normalisht vlerësohet duke e krahasuar me *background*-in natyror lokal.

Niko Peleshi – Atëherë, si propozoni ju të formulohet?

Besnik Baraj – Unë propozoj të thuhet: “Ndalohet hedhja e substancave të rrezikshme në tokë, në ujë dhe në ajër”.

Niko Peleshi – Zonja Xhilda, të lutem, na bëj një koment!

(Zonja Pinci flet pa mikrofon.)

Besnik Baraj – Pra, ai ligji i veçantë e trajton këtë rast?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti prokuror!

Artan Syziu – Të gjitha këto dispozita që po lexojmë, konsiderohen dispozita blankete ose të bardha. Pra, ajo që tha ekspertja dhe drejtoresha që kam në krah: këto çështje mund të

zgjidhen nëpërmjet formulimeve precize në ligjin respektiv, sepse kjo dispozitë nuk mund të zbatohet pa iu referuar ligjit përkatës. Pra, termi “i bërë tej kufijve të normave të lejuara”, mund të interpretohet në ligjin përkatës se cila është kundërvajtja administrative dhe kur formon vepër penale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se e nënkupton: ndotja e ajrit, ndotja e ujërave e kështu me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vijmë te mendimi juaj se jo çdo gjë duhet të penalizohet. Dispozita që lexuat, zoti kryetar, pas ndërhyrjeve nga EURALIUS-i, që ka specialistë të mirë, mendoj se ishte shumë korrekte.

Niko Peleshi – Urdhëroni, drejtoresha!

Esmeralda Velaj– Kjo është e përcaktuar në direktivë. Pra, për sa kohë që në ligjin specifik nuk përbën kundërvajtje penale, konsiderohet si vepër administrative dhe ka dispozita të veçanta. Kështu që kjo është mënyra më saktë e të shprehurit.

Niko Peleshi – E qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do ta votojmë, por ta qartësojmë, që të mos bëjmë gabime të teknikës legislative.

Zoti Beqaj nuk është tani, por më tha, dhe mbase ka të drejtë, këtë mendoj edhe unë, që plagosja dhe gjymtimi mos ndoshta duhet të specifikohen, apo ka ndonjë terminologji në një ligj që i ndan?

Artan Syziu – Plagosja e lehtë është sqaruar saktësisht në ligj. Plagosje e lehtë mund të konsiderohet plagosja që shkakton dëmtim të shëndetit... Edhe për plagosjen e rëndë ka përkufizim preciz në ligj. *(Nuk dëgjohet)*

Niko Peleshi - Po gjymtimi ka nuancë tjetër, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Gjuzi, a keni ndonjë gjë tjetër?

Kujtim Gjuzi – I qëndroj idesë, të cilën zoti Baraj e formuloi saktësisht dhe ajo duhet të mbetet, duke marrë parasysh edhe mendimin e ekspertëve.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Baraj, edhe një herë që ta hedhim në votim, si e propozoni formulimin?

(Diskutime pa mikrofon)

Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ta specifikojmë.

Besnik Baraj – Po.

Niko Peleshi – Kësaj i qëndrojmë.

Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Në qoftë se ju në mënyrë specifike thoni: rrezatimi jonizues tregon se normalisht duhet të kemi një problematikë në vend. Megjithatë, te ne nuk nga pikëpamja sasiore nuk është aq problem, sa kemi mbetje të tjera të rrezikshme. Po the mbetjet e rrezikshme, sigurisht substancat jonizuese janë mbetje të rrezikshme, ndoshta, për ndonjë specifikë të vendit tonë mund të thuash “substancat jonizuese dhe mbetjet e rrezikshme”, që, në fakt, është një lloj përsëritje që nuk është se i jep ndonjë ngarkesë të madhe ligjit, por le të jepet. Kështu që, në qoftë se ju pranoni që të jetë mbetje të rrezikshme, pa dyshim substancat jonizuese janë mbetje të rrezikshme, por për specifikën e vendit tonë ndoshta kolegët kanë pasur parasysh se në zonën e Burrelit ka substanca jonizuese, sepse aty ka pasur një minierë ku donin të zbulonin uranium e tjerë, pra gjeologjia e shtresave atje. Nganjëherë ne huazojmë legjislacionin europian, sepse ai legjislacion është ngritur mbi bazën e specifikave të atyre vendeve. Për shembull, Franca, Ukraina e të tjera kanë reaktorë atomikë dhe materiale bërthamore në mënyrë masive. Franca 80% të energjisë e merr nga reaktorët bërthamorë ose më shumë. Sigurisht, atje është problematikë e madhe. Ne e futim. Kemi pasur situata të tilla, për shembull, te ligji për mbetjet jemi shprehur për mbetjet nga oksidi i titanit. Ne nuk kishim as minierë dhe asgjë, por thjesht ishte një transplant që i kemi bërë ligjit të direktivave europiane, pa parë specifikat e vendit tonë. Për mua bëni si të doni. Po të doni, lëreni “substanca jonizuese dhe mbetje të rrezikshme”. Nuk është ndonjë parazitizëm në këtë terminologji, ose mund ta lini vetëm “mbetje të rrezikshme”, që inkludon edhe mbetjet e substancave jonizuese. Por që ky ligj të jetë afatgjatë nesër dhe pasnesër, sikurse thoshte zoti Berisha që mund të kemi ndonjë reaktor bërthamor këtu për prodhim energjie, ndoshta lëreni edhe këtë “mbetje jonizuese”, por “mbetja e rrezikshme” nuk i prish këtë material.

Faleminderit!

Artan Syziu – Shqetësimi të deputetit mendoj se i jep zgjidhje neni 201/b dhe neni 201/c, që janë në vijim.

Niko Peleshi – E hedhim në votë variantin me ndryshimin e propozuar nga zoti Baraj që fjala “ujërat” të zëvendësohet “me ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore”, pra “ndotja e ujërave” të specifikohet.

Më poshtë ose: “futjes së rrezatimit jonizues dhe mbetjeve të rrezikshme ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, i bërë tej kufirit të normave të lejuara dënohet me burg deri në 3 vjet”.

(Diskutime pa mikrofon)

E hedhim në votë propozimin.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 6, pas nenit 201 shtohen nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/d dhe 201/e me këtë përmbajtje. Nuk po e lexoj, sepse e keni më poshtë. Bëhet fjalë për shkaktimin e fatkeqësive mjedisore, menaxhimin e mbetjeve, transportimin e mbetjeve, aktivitetet e rrezikshme, materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme. Pra, janë si paragrafë, i keni përpara.

Ndërkohë, në krahun e djathtë, në kolonën e katërt kemi draftin e riformuluar. Vini re komentin në fund të faqes tjetër, ku thuhet: “Në nenin 201/b janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, si dhe është bërë një rregullim i renditjes së paragrafëve, sipas rëndësisë së veprës”. Pra, grupi i punës i konsultuar edhe me EURALIUS-in për ta koformuar me direktivën ka bërë këtë riformulim.

Në fakt, kemi edhe një koment tjetër për nenin 201/c, ku janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, si edhe propozohet që të ketë një ndryshim në masën e dënimit, duke hequr minimumin e dënimit me burg. Bëhet fjalë për transportimin e mbetjeve.

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Kam një pyetje për nenin 201/e.

Këtu thuhet: “Mbetje dhe substanca radioaktive të rrezikshme”. A ka substanca radioaktive jo të rrezikshme?

Klodiana Marikaj – Po u referohemi dy dokumenteve të ndryshme. Pjesa e ndryshimeve nuk kanë qenë pjesë e propozimeve tona. Faktikisht, kemi kaluar nenin 201/a, që e

kundërshtuam. Ishte shkaktimi i fatkeqësive mjedisore për faktin asnjëri nuk mund të shkaktojë fatkeqësi, përderisa është fatkeqësi, pra është një fenomen natyror. Kështu që ne ramë dakord në Komisionin e Ligjeve për ta hequr këtë nen, pra neni 201/a “Shkaktimi i fatkeqësive mjedisore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatkeqësitë janë cunami, përmbytjet, tërmetet, zjarret nga rrufetë e të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të forcave njerëzore.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Zonjë, a keni informacion që është e dëmtuar e gjithë pjesa e Krujës nga fabrika e çimentos? Si mund ta heqësh kaq kollaj? Nuk është fatkeqësi nga ne, jo nga cunami, jo nga natyra?!

E nderuar drejtoreshë, ju lutem shikojeni edhe një herë! Si mund ta heqësh të gjithë nenin 201/a?

Të nderuar kolegë, kërkoj që ta rishikojnë me kujdes. Përsëri kërkoj aleancë me zotin Baraj!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Syziu – Është e vërtetë që titulli i dispozitës është i gabuar, nuk mund të ketë shkaktim të fatkeqësive mjedisore. Në të drejtën penale rasti fatkeq është baras me pafajësi, ose faktor quhet ndryshe, por vetë dispozita është e nevojshme. Pra, në vend që të themi shkaktimi i fatkeqësive mjedisore, themi shkaktimi i dëmeve në mjedis ose i prishjes së ekuilibrit natyror, siç është vetë përmbajtja e dispozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëria në këtë rast ka shumë të drejtë për Krujën.

Pra, në kode të tjera penale është prishja e ekuilibrit natyror ose e bukurive natyrore.

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Kujtim Gjuzi – E falënderoj në mënyrë të veçantë prokurorin për rastin e Krujës, sepse jam përfaqësues ligjor i zonës!

Niko Peleshi – A ka ndonjë propozim tjetër?

Atëherë, kemi propozimin për të shtuar një paragraf, pra paragrafi 201/a, i cili në variantin e përpunuar është hequr, të zëvendësohet me një paragraf me titull, pak a shumë,

“Prishja e ekuilibrit natyror të një ekosistemi apo prishja e ekuilibrit natyror”. Kjo kërkon një riformulim. Natyrisht, nuk mund ta marrim ne përsipër ta bëjmë, por duhet t’i kërkojmë dhe t’ia rekomandojmë Komisionit të Ligjeve që ta përfshijë si paragraf, me një riformulim të përshtatshëm.

Kujtim Gjuzi - Zoti kryetar, edhe një sekondë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Të lutem, Kujtim!

Të shtohet edhe ky nen. Deri tani këtë propozim kemi, nuk kemi propozim tjetër.

Urdhëro, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Atëherë, le ta specifikojmë që prokurori gjeti tamam atë që duhet, atë që ne të gjithë ramë dakord. T’i dimë këto dhe t’i marrë vesh komisioni tjetër.

Unë kam qejf t’i vendos pikat mbi i. Në gjuhën shqipe themi: i-ja e madhe nuk ka pikë dhe i-ja e vogël ka pikë. Në këtë rast prokurori e vendosi pikën mbi i. Këtë rast duhet ta marrim në konsideratë, duhet t’ia njohim!

Niko Peleshi – Dakord. Do ta votojmë pikë pas pike. Jemi te neni 6.

Kush është dakord të ndryshohet titulli i nenit 201/a duke e specifikuar: “Prishja e ekuilibrit natyror”, ose të vihet si të çmohet e përshtatshme nga Komisioni i Ligjeve.

Kush është dakord me këtë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, të mos hiqet, por të riformulohet dhe të ketë këtë titull.

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika tjetër është ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! E lamë që do ta riformulojë Komisioni i Ligjeve.

E falënderojmë edhe zotin prokuror për këtë propozim që, siç e tha me të drejtë zoti Gjuzi, ishte me vend.

Pika tjetër ka lidhje me nenin 201/b, “Menaxhimi i mbetjeve”. Kush është dakord të miratohet siç është formuluar në variantin e përpunuar, pra sipas kolonës 4, që po diskutojmë?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika tjetër ka lidhje me nenin 201/c.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 201/d, që ka lidhje me aktivitetet e rrezikshme.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 201/e. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Artan Syziu – Është i papranueshëm formulimi: me gjobë ose me burgim nga 2-5 vjet. Në rast se ligji parashikon gjobë, duhet të parashikojë një maksimum, sepse nga gjoba deri te 2-vjetëshi krijohet një hapësirë e papranueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te të gjitha dispozitat edhe te c-ja, edhe te d-ja, edhe te e-ja. Te të gjitha. Ky togfjalësh është i papranueshëm. Pra, minimumi i burgimit duhet të hiqet, se është në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal deri në 5 ditë.

Niko Peleshi – Dakord.

Atëherë, para se të bëjmë votimin dhe miratimin në tërësi të nenit 6, të shtojmë si te nenet e tjera këtë rekomandim për Komisionin e Ligjeve për ta riparë dhe për ta rivlerësuar me vëmendje masën e dënimit të diferenca midis dënimit më të ulët dhe dënimit më të lartë, për ta bërë atë më realist dhe më efektiv.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këtë po thosha. Te propozimi nga gjobë deri në burgim, ne rekomandojmë të jetë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te pika “c” dhe te pika “d”, aty ku është masa e dënimit.

Kush është dakord në tërësi me nenin 6?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me këto vërejtje.

Besnik Baraj - Kur thua “mbetje radioaktive”, a është e nevojshme të jetë edhe e rrezikshme? A nuk nënkuptohet kjo?

Klodiana Marikaj – Kështu e parashikon ligji specifik. Megjithatë, ka edhe substanca, të cilat nga natyra e tyre nuk janë radioaktive dhe gjatë një ekspozimi të gjatë, ato kanë veprimtari kumulative dhe shndërrohen në substanca radioaktive, të cilat janë në formë gjurme. Kështu, duhen cituar të dyja rastet.

Niko Peleshi – Kalojmë te neni 7, që ndryshon nenin 202 si më poshtë: “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”. Lexoni variantin e përpunuar në kolonën 4!

Kush ka ndonjë koment?

Kush ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, lexoje!

Kush është dakord të miratohet neni 7, siç është formuluar?

Kujtim Gjuzi – Të nderuar kolegë,

Këtu kërkoj përsëri më shumë vëmendje për këtë nen, sepse qeveria aktuale, pavarësisht mendimeve të mija kundër saj, mund të them se ka qenë korrekte në lidhje me mbrojtjen e faunës së egër (nga shpendët, deri te kafshët e egra). Pra, në këtë moment mund të kishte një mendim më të qartë të ekspertëve, siç është rasti, zoti prokuror, ne gjithmonë tentojmë të minimizojmë korrupsionin që ka ndodhur në drejtësi (nuk bëhet fjalë drejtpërdrejt për ju, por për njerëz të tjerë). Kemi parë arrestime të prokurorëve për pastrim të parave apo për diçka të tillë, që nuk kemi dëshirë të ndodhin më. Si mundemi ta minimizojmë këtë? Mendoj se do të kemi korrupsion, por të paktën ta minimizojmë atë. Si mendoni, shkëlqesi prokuror?

Faleminderit!

Artan Syziu – Unë mendoj se dispozita është korrekte. Mund të bëhet një përkufizim tjetër për sa i takon terminologjisë “sasi e papërfillshme”, sepse në praktikë bëhet shumë e vështirë për ta ndarë sasinë e papërfillshme nga sasia e përfillshme. Mund t’i sugjerohet Komisionit të Ligjeve për të gjetur një term më të përshtatshëm, më preciz, sepse lihet shteg për abuzim.

U jap të drejtë konstatimeve të zotit Gjuzi.

Niko Peleshi – Dakord.

Atëherë, kush është dakord me nenin 7, siç është dhe me kërkesën për një reformulim nga Komisioni i Ligjeve për ridefinimin e togfjalëshit “sasi e papërfillshme”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të përdorim shënimin që përdorëm edhe për dispozitat e tjera për sa i përket masës së dënimit.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Kujtim Gjuzi – Po marr një rast konkret. Unë shkoj përballë prokurorit, se kam vlarë disa shpendë me çifte me leje (nga 2 deri 6 rosa). Prokurori më thotë se dënohem me 7 vjet burg, meqë kam vlarë 6 rosa, sepse nuk kam futur njeri për një ndërhyrje te prokurori. Atëherë, unë fus zotin Shtjefën si jurist, që të ndërhijë. Prokurori i kërkon 20 mijë euro të shkojnë te makina e prokurorit. Skandaloze!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, le ta ulim pak diferencën e dënimit ta bëjmë 2-4 vjet që të mos shkojmë në 200% të gjësë. Të paktën ne, si ekonomistë nuk e kemi këtë. Ne kemi 1-3vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, 1-3vjet, siç e propozon kolegu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk merr dot 5000 euro për një prokurë.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ju kërkoj ndjesë, nëse ju kam krijuar besdi!

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi,

Ju keni të drejtë, nuk është bezdi, por në çdo dispozitë që ka masa dënimi, do të bashkëngjisim në relacion idenë e prokurorit për të rekomanduar rishikimin e masave të dënimit që të mos ketë shumë diferenca, sepse te diapazoni të gjitha aludimet tuaja mund të kthehen në realitete të hidhura.

Neni 8, të shtohet neni 202/a, me këtë përmbajtje:

"Neni 202/a, Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore

Veprimet në shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitate, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore, dënohen me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Ka ndonjë mendim apo ndonjë propozim për këtë nen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, siç e thamë, edhe këtu ka dispozitë masash. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9 që ndryshon nenin 203, “Substancat ozon-holluese”.

“Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja ne treg ose përdorimi i substancave ozon-holluese duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”

Ka një pyetje nga komisioni, nëse është dekriminalizuar ndotja e ujërave, apo jo. Kjo pasi është hequr neni ekzistues për ndotjen e ujërave pa u rregulluar në ndonjë nen tjetër të projektligjit.

Është futur? Dakord, në rregull.

Për nenin 203, që ndryshohet me nenin 9 të projektligjit, propozohet që të hiqet dënimi me gjobë.

Gjithashtu, ka një propozim që dënimi me burg të jetë më i ulët, deri në një vit. Këto janë pak a shumë, rekomandimet që na vijnë. Si mendoni, ta votojmë siç është apo keni ndonjë propozim?

Kush është dakord me nenin 9, siç është formuluar? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10. Pas nenit 207, shtohet neni 207 /1, me këtë përmbajtje:

"Neni 207 /1

Shkelja e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit

Shkelja e rregullave për mbajtjen dhe shoqërimin e kafshës, mbajtja pa kujdesin e duhur të kafshës së shoqërimit, mosvendosja e maskës mbrojtëse qenve agresivë, nxitja me qëllim

egërsimin e kafshëve që paraqet rrezik për njerëzit, në mjedise publike apo të hapura për publikun, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga tridhjetë mijë deri në njëqind mijë lekë.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e lehtë e një personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e rëndë e një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet."

Urdhëro, zoti Valteri!

Halit Valteri – Jam dakord me të gjitha që janë parashikuar në nenin 207/1, por problemi është te masat, te ashpërsimi i tyre nga 3-10 vjet. Të gjithë kemi kafshë shtëpiake dhe nuk është se ...

Jam dakord që duhet të merren masa, duke u vënë maska, duke i lidhur apo duke i shoqëruar për kushte sigurie, por masa e dënimit 3-10 vjet dhe 1-5 vjet sikur është shumë e rënduar për një ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka pse të dënohet njeriu për këtë pjesë, se nuk e bën ai dëmin.

Kaq kisha.

Niko Peleshi – Zoti Pendavinji!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Zoti Pëllumbi dhe më pas e ka fjalën zoti Gjuzi.

Arben Pëllumbi – Zoti prokuror,

Desha të sqarohesha nga ju, se në këtë nen ne i përcaktojmë kufijtë e gjobës, ndërkohë që në të gjitha nenet e tjera kemi thënë se dënohet me gjobë pa i përcaktuar kufijtë. A ka vlerë t'i përcaktojmë kufijtë këtu?

E dyta, minimumi me maksimumin e dënimit kanë një diapazon shumë të gjerë. Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Personi ka vdekur në këtë rast, pse duhet ky diapazon kaq i gjerë? Çfarë kuptimi ka? Çfarë nënkupton me 3 vjet dhe çfarë nënkupton me 10 vjet?

Cili është gabimi që ka bërë mbajtësi i kafshës që mund ta dënosh me 3 vjet ose me 10 vjet? Çfarë rrethane ka shkelur mbajtësi i kafshës, që e lehtëson me 3 vjet apo e rëndon me 10 vjet?

Artan Syziu – Duhet gjykuar rast pas rasti. Ka raste që ka një qëndrim në vijimësi për mbajtjen e kafshës pa i vënë mbrojtësen e nevojshme. I kanë folur komshinjtë disa herë, ka pasur raste plagosjesh të lehta të komshinjve dhe ai vazhdon ta mbajë qenin pa mbrojtëse. Ka raste në botë që janë dënuar për vrasje me dashje indirekte. Pra, ai mban një qen të madh që dihet që është shumë i rrezikshëm te Kodrat e Liqenit dhe mund të shkaktojë vdekjen e një fëmije. Duhet gjykuar rast pas rasti. Bie fjala bën përpjekje për ta mbajtur kafshën...

Ky diapazon është i lidhur me veprimet ose mosveprimet e shoqëruesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Këtu thuhet: qentë agresivë. Ne të gjithë në një farë mënyre jemi qenie inteligjente dhe hyjmë ndonjëherë edhe vetë te kategoria e të rrezikshmëve, por inteligjenca jonë nuk na lejon të futemi te kategoria e të rrezikshmëve, por kam pasur rastin e një qeni agresiv

Isha një natë me nusen dhe me djalin dhe ishte një qen që më trembi edhe mua, megjithëse unë nuk trembem kollaj. I thashë të zotit t'i vinte një maskë qenit Pitbull, por ai m'u përgjigj që duhej të ikja, sepse nuk kishte se ç'më duhej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu duhet një masë dënimi fikse, sipas mendimit tim. Po u kafshua lehtë, apo egër, dënimi të jetë 5 vjet. Të shkojë në burg ai zotëria atje që ta marrë vesh se kush isha unë, apo kush ishte qytetari tjetër. Ai duhet ta kuptojë që s'mund të dalë në rrugë me qenin pa i vënë një maskë mbrojtëse.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka ndonjë propozim tjetër?

Zef Shtjefni - Paragrafi i dytë që thotë: 1-5 vjet, a mund ta bëjmë 1-3 vjet?

Paragrafi i fundit që thotë se dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet, është sipas rastit. Për mendimin tim, diapazoni i masës së dënimit është shumë i gjerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, por variantet janë të ndryshme. Nuk është vetëm një rast, por mund të vijnë shumë raste të ndryshme dhe e parashikon. Kjo gjë duhet parë.

Niko Peleshi – Fjalën e ka kërkuar zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do ta nisja kështu. Në fillim të paragrafit, aty ku thuhet: “maskës mbrojtëse të qenve agresivë”, ndoshta fjala “agresivë” duhet hequr dhe të lihet “të qenve”, sepse kush do ta ndajë është ose jo agresiv. Qentë mund të egërsohen në një moment të caktuar dhe të dalin nga kontrolli.

Për sa i përket pjesës së dënimit, unë, si mjek, mendoj se këto dënime duhet të jenë në këtë masë, sepse edhe plagosja e rëndë e personit, nga një deri në pesë vjet, e thashë, në kushtet e shoqërimit të një qeni ose një kafshe, e cila del nga kontrolli, personi që e mban, kujdestari, përpiket... Atëherë, patjetër që do të ketë masë lehtësuese.

Në momentin që i ka ikur, qeni është shumë i madh, a ku ta di unë, egërsohet shumë, patjetër që do të vlerësohet përpjekja që ka bërë personi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse dënohet personi. Në qoftë se ky është përpjekur, ose e ka lënë të lirë, ndryshon shumë njëri akt nga tjetri. Të dënohet për të dyja veprat, edhe për plagosjen e rëndë të personit, sepse ai mund të gjymtohet për gjithë jetën, por edhe përpjekja e personit që e posedon këtë kafshë shtëpiake...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Syziu – Mendoj se sugjerimi i deputetit është korrekt, pasi në praktikë është e pamundur t’i ndash qentë agresivë nga ata joagresivë. Pra, në rast se ke marrë përsipër të mbash një qen, ai mund të duket joagresiv, por në një moment të caktuar mund të bëhet agresiv. Ajo duhet hequr.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo që tha deputeti tjetër lidhur me gjobën, është shumë e drejtë, pasi, duke e krahasuar me nenin 34 të Kodit Penal, rezulton që shumat e gjobave bien ndesh me formulimin e përgjithshëm për gjobën. Pra, duhet të hiqet dhe le të lihet: “dënohet me gjobë”, pa e dhënë shumën e gjobës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Propozimi që bëhet për heqjen e fjalës “agresiv”, e zgjeron gamën e kafshëve shoqëruese, që nga ajo konka e vogël, që e ka gojën sa maja e këtij stilokalemi, deri te qeni, që vërtet mund të kthehet në një armë vrasëse.

Pra, në rast se fjala “agresive” hiqet, duhet të specifikohet pastaj. Nuk e di si është në ndonjë ligj tjetër ose në dispozitë tjetër për të përcaktuar llojin e kafshës, e cila është agresive ose duhet të mbajë maskë, pasi është e pamundur t’i detyrojmë të gjithë mbajtësit e qenve që t’i pajisin ato me maska; ka edhe qen pa asnjë lloj rrezikshmërie.

Po e lamë pa këtë fjalën këtu, duhet që çdo shoqëruar, kur del me kafshën e tij në ambiente publike, t’i vendosë maskën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord, por e mendoni një *Chihuahua* me maskë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, se duhet të flisni sipas kësaj radhe: zoti Konomi, zoti Valteri dhe pastaj zoti Gjuzi.

Ardit Konomi – Mendoj se duhet të shikojmë pak përcaktimin e kafshës së shoqërimit, sepse unë di që në disa legjislacione është zgjeruar shumë gama e kafshëve të shoqërimit, por nuk e di nëse edhe ne e kemi të përcaktuar ose jo. Në disa raste kanë futur një pjesë felinësh si kafshë shoqërimi: baldosat e të tjerë. Ndoshta e thëna “qen” e kufizon.

Halit Valteri – Ka një konventë ndërkombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardit Konomi – Në qoftë se është specifike...

Halit Valteri – Më falni, kam edhe një pyetje, por më shumë teknike!

A parashikohet gjë në këtë ligj për qentë e rrugës? Kush do të dënohet, bashkia? Do të dënojmë Erion Veliajn ne tani, për shembull, kur kafshon një qen rruge? Kush do t’ia vendosë maskën qenve të rrugës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se po flasim vetëm për qentë, po i paragjykojmë, ata që kanë pronarë. Hajde të flasim edhe për ata, me të cilët është mbushur plot Tirana. Kush mban përgjegjësi në këto raste? Për shembull, në qoftë se mua më kafshon një qen rruge, kë do të dënojmë, drejtorin e Përgjithshëm

që merret me qentë, apo kryetarin e bashkisë? Apo do të marrim ADN-në dhe ta gjejmë kështu, me ato 1000 faqet?!

Faleminderit!

Niko Peleshi – Para se ta marrë fjalën zoti Gjuzi, a keni ndonjë mendim për këtë shqetësim, sepse duket vërtet...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – Jemi në unison. Domethënë, kur kemi marrë edhe Barajn këtë nga opozita, është gjë e mirë, po funksionon gjëja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valter, mos të të duket çudi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi përsëri te kjo zona, për të cilën zoti kryetar pyeti: po qenve të vegjël bukuroshë? Ore, edhe ai qen është, të kafshon, i lëviz...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doni një fakt konkret? Ta hap këtu? I vogël ishte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Syziu – Zoti kryetar, kjo dispozitë është e diktuar nga konventa ndërkombëtare që ka ratifikuar shteti shqiptar.

Për sa u takon qenve të rrugës, ka një dispozitë të përgjithshme në Kodin Penal, që quhet shpërdorim detyre. Në rast se, po themi, bashkia ka një drejtor, që ka për detyrë të merret me këtë punë dhe dëmtohen persona, atëherë do të përgjigjet personi funksionar publik i bashkisë ose ai i Ministrisë së Mjedisit (nuk e di nëse ministria e ka detyrë funksionale).

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është objekt i këtyre ndryshimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Halit Valteri – Në dijeninë time, nuk kemi një rast kur është dënuar një përgjegjës për shpërdorim detyre, ndërkohë që raste të sulmeve ndaj qytetarëve nga qentë e rrugës kemi çdo ditë fatkeqësisht.

Niko Peleshi – Kjo është situatë e rregulluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po në ligj bëhet përgjegjës...

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, me leje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa të mbarojë zoti Baraj.

(Deputetët Baraj dhe Valteri diskutojnë flasin pa mikrofon.)

Besnik Baraj – Nga pikëpamja teorike ke shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – Më lejoni të flas, zoti kryetar, pasi është radha ime?

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Së pari, e falënderoj zotin Baraj, që, si liberal që është, thotë: “I referohem zotit Gjuzi”. Mos harroni, i nderuar zoti Baraj, pavarësisht aleancave fluide, unë jam konservator.

(Ilaritet në sallë)

Kjo do të thotë që unë dua mbrojtje, sepse pikërisht në prefekturën Durrës-Krujë-Shijak ndodhi kafshimi i qenit mu në mes të Durrësit. Ma jepni një përgjigje tani si t’ia bëjmë? Kë kemi përgjegjës në atë rast?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju falënderoj, por duke pasur zotin Peleshi, që vjen nga qendra e djathtë këtu, ju keni reflektuar, kjo është gjë e mirë! Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Drejt konservatores po shkojmë të gjithë!

Ka ndonjë propozim?

Lidhur me përkufizimin “qen agresiv”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di, zoti Pendavinji, ju që e propozuat, si e shikoni një qen *Chihuahua* me maskë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – Kemi kthyer buzëqeshjen në komision, është gjë e mirë!

Këtu rriheshin njerëzit me grushte. Sa mirë është tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, i ra me grusht. Thashë unë atje në shtëpi: çfarë bëjnë këta, more vëlla, këta duhet të jenë boksierë?!

Niko Peleshi – Ka demokraci tani ne që vijmë nga qendra e djathtë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – E kemi zbutur.

E kuptoni sa mirë keni reaguar? Sidomos pas konferencës shkencore në Akademinë e Shkencave, të Konferencës së Mukjes! Shikoni çfarë reagimi keni bërë brenda tetë muajve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I nderuar, unë nuk mund të bëj fushatë me vrasësit e Ardit Gjoklajt! Madje, kolegu im i bëri reklamë, sepse reklama për ne, ekonomistët, është edhe pozitive, edhe negative, por në fund fare është reklamë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, edhe një herë, unë jam që qentë duhet të dalin me maskë.

Imagjinojeni, unë jam në një moshë madhore, 60 vjeç, që nuk kam njeri frikë, por kur më afrohet qeni... Më tha dikush: “Përkëdhele pak këtë qenin”, ia ktheva: “Jo, more, se ai të kafshon!” E besoni që më pa qeni me inat dhe m’u sul? Shyqyr që kisha xhuboksin, madje për pak ma gërvishti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Besnik Baraj – Zoti Gjuzi, a ta kalojmë këtë, sepse legjislacioni europian, me siguri, e ka që duhet vënë maskë te qentë e vegjël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – Nuk akuzohem...

Shprehja “Shkëlqesi, prokuror!” ku është? Ja, le të më thotë nëse i është drejtuar njeri kështu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! Jemi kolegë të mrekullueshëm!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shiko, o, nip i Gjergj Fishtës: se çfarë thotë Europa, është qejf i saj! Tani, të them unë që Europa sjell ndonjëherë këtu mbetje radioaktive, jua thashë më përpara!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faktet, zoti Baraj, do t'i trajtojmë pak më vonë nëpërmjet interpelancës ndaj kujt të na mbushet mendja ne të thërrasim, qoftë edhe ministrin e Mjedisit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qentë janë gjithmonë qen, janë kafshë, edhe shtëpiake, por janë më agresivë ata që mbajnë qentë, që ua sulin njëri-tjetrit në rrugë!

(Deputeti Baraj ndërhyn pa mikrofon.)

Jo, jo, njerëzve jo, nuk mund të ndodhë kjo!

Niko Peleshi – Ecim tani, se jemi në proces votimi.

Kujtim Gjuzi – Për qentë duhet maskë, pikë!

Nëse ka dy mendime, pro dhe kundër, pastaj të shohim se si është puna në medie dhe se çfarë do të them unë më mbrapa.

Niko Peleshi – Dakord.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kush është dakord me propozimin e zotit Pendavinji, mbështetur nga zoti Gjuzi, që të hiqet fjala “agresiv” dhe përmbajtja e nenit të mbetjet: “Mosvendosja e maskës mbrojtëse qenve”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, pra, dënohet mosvendosja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimi tjetër është që të hiqet masa e gjobës, pra të lihen vetëm fjalët: “dënohet me gjobë”, pa e përcaktuar.

(Deputeti Baraj flet pa mikrofon.)

Kush është dakord?

Kujtim Gjuzi – Të bëj një koment përpara?

Niko Peleshi – Ju lutem!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Zoti Baraj, ju, më mirë sesa unë, e dini...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Baraj, m'u drejtuat! Pse bëni subsidiaritete, miku im?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, ne kemi qenin më të mirë që ka Europa, qenin e Sharrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?! Pse ata të tjerët janë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Çfarë duhet të them me këtë! Pra, qentë, që kanë shkuar në Europë, janë emigrantë dhe ne e kemi fajin, madje edhe ne të dy e kemi fajin që ikin të gjithë!

Faleminderit!

Niko Peleshi – Kush është dakord me riformulimin e nenit 10?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kemi hequr fjalën “agresiv” dhe nuk kemi përcaktuar masë gjobe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është propozimi.

Besnik Baraj – Unë shprehem kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, se jemi në votim!

Kush është dakord që te neni 10 të heqim fjalën “agresiv”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjuzi, ju lutem, sepse jemi në proces votimi!

Zoti Sina, jemi në votim! Ju lutem!

(Deputeti Sinaj kërkon fjalën pa mikrofon.)

E keni ndërhyrjen lidhur me heqjen e fjalës “agresiv”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Vullnet Sinaj – Nuk e kuptova që edhe kones së vogël do t’i vëmë maskë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, të mos bëhemi qesharakë të Europës dhe të botës! Nuk i kemi parë në asnjë vend të botës qentë e vegjël me maskë!

(Debat në sallë)

Të mos bëjmë shkencë në Shqipëri!

Unë kam shumë respekt për ju, pasi jeni shumë korrekt dhe flisni në mënyrë parimore, por në këtë rast po bëjmë diçka kineze, vetëm shqiptare, po dalim vetëm ne kështu! Nuk e ka asnjë vend në botë këtë që duam të bëjmë ne! Nuk e kemi parë në Itali, Gjermani, Francë... As kineze nuk janë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë, ta ndajmë me votim këtë çështje. Ju lutem!

Kush është dakord me propozimin që të hiqet fjalën “agresiv” dhe pa përcaktuar masën e gjobës, duke lënë vetëm fjalët: “dënohet me gjobë”?

Një, dy, tre vota pro. Kundër? Shumica e të pranishmëve janë kundër.

Atëherë, nuk miratohet propozimi, ngelet siç është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta hedhim në votë. Kush është dakord me variantin e ardhur nga Këshilli i Ministrave?

Kundër? Dy vota kundër.

Miratohet varianti i Këshillit të Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo pra, se u votua siç është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vijojmë me nenin 11. Neni 237 ndryshohet si më poshtë: “Goditjet për shkak të detyrës. Goditjet ose vepra të tjera dhune ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore dhe shërbimit publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur ose funksionarit publik, për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë, për shkak të veprimtarisë së tij, dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor, për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit, ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin publik ose shërbimin publik, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet”.

Kush është dakord me nenin 11, sipas këtij formulimi? Kundër? Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Luli – Të bëj një sugjerim te neni 11?

Niko Peleshi – Jo, mbaruam, u votua!

Kujtim Luli – Paragrafi i dytë duket si...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, zoti prokuror, se u votua neni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ende kohë, mund ta ngrini si shqetësim te Komisioni i Ligjeve, se këtu u votua, nuk mund t’i kthehemi përsëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 12. Neni 238 ndryshohet si më poshtë: “Kanosja për shkak të detyrës.

Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, dënohet me burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionit publik, kur për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë, për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor, për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pas nenit 238 shtohet neni 238/a me këtë përmbajtje: “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor. Pengimi me çdo mënyrë i ushtrimit të detyrës së

profesionistit shëndetësor në mjediset e institucionit të kujdesit shëndetësor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Konomi!

Ardit Konomi – Pengimi me çdo mënyrë i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor në mjediset e institucionit mund të çojë edhe në pasoja të rënda. Mendoj se nuk duhet të kalohet kaq kollaj në kundërvajtje penale me gjobë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është akt shumë i dënueshëm dhe me pasoja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ushtrimi i detyrës së personelit mjekësor ndaj pacientit.

Niko Peleshi – Zoti Konomi do të thotë se mund të sjellë edhe vdekjen e pacientit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardit Konomi – Pasojat mund të jenë shumë të rënda.

Niko Peleshi – Te cili nen hyn? Në qoftë se për shkak të këtij pengimi, si pasojë vjen vdekja e një pacienti, do të trajtohet njëlloj, me gjobë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozoni të shtohet një paragraf që të lidhë masën e dënimit me pasojën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si mendoni, zoti Shtjefni, se jeni jurist, ta bëjmë një formulim?

Zef Shtjefni – Te ky nen nuk është parashikuar pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor, por ndoshta nga pengimi mund të krijohet edhe një gjë tjetër, mund të rrëmbehet mjeku dhe të futet në një vend të papërshtatshëm dhe si pasojë mund të ketë vdekur një pacient, por këtu nuk e thotë. Mund të shtohet kjo që thotë zotëria në fjalë. Ta formulojmë ndryshe. Për këtë çështje mund të shprehet edhe prokurori.

Niko Peleshi – Zoti prokuror, a mendoni se duhet të bëjmë një diferencim për...

Artan Syziu – Mendoj se shqetësimi mund të zgjidhet duke shtuar një paragraf të dytë, “kur pengimi ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Gjobë, pra.

Ta mbarojë fjalën.

(Diskutime pa mikrofon)

Që të mos i japim shumë ngjyrimë, a ia vlen të bëjmë 2 paragrafë, paragrafin e parë, siç është, dhe paragrafin e dytë: “pengimi i ushtrimit të detyrës për profesionistin shëndetësor me pasojë fatale për pacientin”? Pra, ta diferencojmë vetëm kur ka vdekje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kjo është shumë e komplikuar. Nuk e di...

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Syziu – Veprimi i këtyre personave mund të kualifikohet si vrasje me dashje indirekte. Ti e di shumë mirë, po të mos i shërbejë mjeku në kohën e duhur pacientit, që ka ardhur në urgjencë, ai do të vdesë. Kështu që e pengon dhe do të përgjigjet për vrasje me dashje indirekte.

Niko Peleshi – Atëherë, nuk ka nevojë të shtojmë nen, sepse i referohet një dispozite tjetër pastaj.

Si mendoni, zoti prokuror?

Artan Syziu – Mendoj se një paragraf i dytë do të ishte i dobishëm, kur ka sjellë pasoja të rënda.

Niko Peleshi – Pra, vetëm kur ka sjellë pasoja fatale.

Artan Syziu – Kur ka sjellë pasoja për shëndetin.

Niko Peleshi – Pasoja sjellë gjithmonë. Hajde ta ndash pastaj nëse solli pasojë ose jo mungesa e mjekut, se në çdo rast një lloj pasoje e sjell!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbetet siç është, të mos shtohet nen tjetër.

Artan Syziu – “Kur pengon mjekun dhe sjell një pasojë të rëndë për shëndetin, do të përgjigjet për plagosjen e rëndë të shkaktuar me dashje indirekte.”

Niko Peleshi – Sipas dispozitave të tjera.

Nuk ka nevojë të shtojmë parashikime këtu.

Ardit, je dakord me këtë qëndrim, apo insiston për një propozim tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, prokurori thotë që në rast se ka pasoja të rënda, u referohet dispozitave të tjera dhe dënohet. Pra, nuk e kalon me një gjobë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dënohet, por nuk ka nevojë ta lidhim me pengimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë thotë prokurori. Ideja është që do të dënohet për vrasje, për plagosje, me dispozita të tjera.

Esmeralda Velaj – Janë dispozitat për kanosje, për dhunën... Janë kapituj të tjerë. Këto janë te kapitulli për jetën dhe shëndetin. Kjo e ezauron, pasi pengimi me çdo mënyrë i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor, presupozohet të bëhet në vendin e punës. Ka edhe një staf aty. Pra, ky pengim nuk do të shkaktojë vdekjen e personit...

Niko Peleshi – Ardit, je dakord apo ke ndonjë propozim? Nëse ke ndonjë propozim, e hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E qartë, nuk ke propozim.

Atëherë, e hedhim në votë variantin sipas Këshillit të Ministrave.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër nuk ka, 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 14. Te neni 274, “Prishja e qetësisë publike”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf: “Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon, gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, kur është marrë më parë masë administrative, dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë ose me burgim deri në 2 vjet”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te neni 15. Pas nenit 274 shtohet neni 274/a dhe 274/b.

Neni 274/a ka lidhje me goditjen e sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit sportiv. “Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim nga 1-3 vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në mjedise sportive më shumë se një herë apo është kryer nga drejtues ose anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga 1-5 vjet”.

Neni 274/b, “Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive”. “Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike,

fishekzjarrëve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktivitetit sportiv, dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet. Hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona të paautorizuar ose pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga 1-3 vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në aktivitete sportive ndërkombëtare, dënohet me burgim nga 1-5 vjet.”

Keni ndonjë koment?

Kush është dakord me votimin në parim të nenit 15?

Halit Valteri - Unë them të shkojmë edhe ne për vizitë, si Gjuzi, në burg, por...

Kam diçka...

Niko Peleshi – Në parim, si fillim. Meqenëse ka 2 pika, ta votojmë në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Halit Valteri – E kam vetëm për pjesën e mbajtjes së flakadanëve. Çfarë problemi ka të mbajnë tifozët flakadanë? Të gjithë tifozët mbajnë flakadanë.

Artan Syziu – Është e rrezikshme.

Halit Valteri – Jo të rrezikshme, po flas për flakadanët. Duhet ta ndajmë këtë.

Niko Peleshi – Flakadanët bëjnë flakë, zjarr... Cilët quhen flakadanë?

Halit Valteri - Ata me ngjyrues blu, të verdhë, të kuq...

Niko Peleshi – Ata nuk quhen flakadanë.

Halit Valteri – Flakadanë quhen ata.

Niko Peleshi – Flakadani bën flakë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Halit Valteri – Dakord.

Person m – Nuk bëhet fjalë për tymueset.

Halit Valteri – Jo për ato? Dakord.

Faleminderit!

Ilir Pendavinji -...erdha pak me vonesë, por çështjet e ushtrimit të profesionistit i ka shqyrtuar komisioni përgjegjës. Edhe këto çështje duhet t'i kenë shqyrtuar ata që merren me sportin, arsimin dhe...

Mbase duhet të ecim sa më shpejt, sepse ata i kanë shqyrtuar.

Niko Peleshi - Kush është dakord në parim me nenin 15? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me pikën 274/a? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 274/b. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me nenin 15? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16. Te neni 278, paragrafi i parë ndryshohet me këtë përmbajtje: “Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse, në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga 5-7 vjet. Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga 7-15 vjet.”

Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Pas nenit 278/a shtohet neni 278/b me këtë përmbajtje: “Prodhimi, mbajtja dhe tregtimi i armëve bërthamore nukleare ose kimike, i dëmtimit në masë të popullsisë, dënohet nga 15-20 vjet burg”.

Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Te neni 282 ndryshohet titulli i nenit, “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse”. Togfjalëshi “ose substanca radioaktive” shfuqizohet në paragrafin e parë. Shenja e pikësimit, presja, pas fjalëve “lëndë plasëse” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Te neni 282/a, titulli i nenit ndryshon si vijon: “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”. Fjalët “dhe substanca radiokative” në paragrafin e parë shfuqizohen. Shenja e pikësimit, presja, pas fjalës “i djegshëm” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Neni 288 ndryshohet me këtë përmbajtje: “Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, pijeve, lëndëve të tjera ushqimore, barnave të rrezikshme...

Kështu quhet kjo? Apo është “e bimëve të rrezikshme”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, sipas variantit të riformuluar: “Cilido që importon, prodhon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim me ndonjë mënyrë tjetër ushqime të rrezikshme, si dhe shton gjatë prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportit dhe/ose shitjes, kimikate materiale dhe lëndë shtesë joushqimore të ushqimeve, në shkelje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm dhe që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, dënohet me burgim deri në 3 vjet”.

Kush është dakord? A ka komente?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillimisht do të flasë zoti Sinaj. Më pas e kanë fjalën përfaqësuesit e ministrisë dhe zoti Valteri.

Vullnet Sinaj – Po ta shikosh nenin 20, thuhet: “Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin”. Unë kam vërejtje, sepse këtu bëhen të gjithë bashkë. Bëhen bashkë importuesi, prodhuesi, ruajtja, shitja dhe nuk merret vesh i kujt është faji. “Prodhimi, importimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër të ushqimeve, pijeve dhe lëndëve të tjera ushqimore, barnave të rrezikshme, si dhe futja në prodhim e kimikateve (futjen në prodhim të kimikateve nuk e bën importuesi, as shitësi, por prodhuesi), materialeve dhe lëndëve shtesë, në prodhimin dhe përpunimin e artikujve ushqimorë, të pijeve në shkelje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm (cili është ky legjislacion i posaçëm?), dënohet me burgim deri në 3 vjet”.

Për mua, ky është një miks ndërmjet importuesit, prodhuesit dhe tregtarit. Duhet të ndahet kjo. Futja e produkteve apo kimikateve të dëmshme për shëndetin bëhet nga prodhuesi. Pra, duhet të përcaktohet kush e ka fajin. I keni bërë të gjithë bashkë dhe unë nuk jam dakord.

Ç’punë ka ai, që e merr mallin dhe e importon, me atë që ka bërë prodhuesi?! Ku e di tregtari (mund t’i shkojë në rregull certifikata) se çfarë ka futur prodhuesi brenda?

Unë kam parë edhe legjislacionin italian, kodin penal për sigurinë ushqimore. Këto që po bëjnë ne nuk kanë lidhje fare me të. Atje janë të ndara. Prodhuesi ka problemet e veta, importuesi të vetat, tregtari të vetat.

Jam i mendimit të ndahet përgjegjësia. Në këtë rast përgjegjësia duhet të jetë e prodhuesit, nuk kanë punë të tjetër këtu. Të mos e bëjmë “merri dhe futi të gjithë brenda dhe ta hajë kush ta hajë...!”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ç'punë ka tregtari me prodhimin dhe futjen e lëndëve kimike?! Ma thuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, një sekondë!

Pardje jam helmuar. Kam blerë një pije alkoolike në një dyqan në rrugë dhe ishte false. E dallova, se më dhimbte koka. E di edhe këtë gjë. Por, në fund, kush e ka fajin? Fajin e ka ai që e ka prodhuar. Ai i bën këto gjëra. Të mos i bëjmë lëmsh, se po ua ngarkojmë të gjithëve përgjegjësinë.

Ti do të shkosh të blesh një produkte te një dyqan, ai e ka blerë me faturë të rregullt TVSH-je dhe me certifikatë të rregullt cilësie. Atëherë, kush e ka fajin këtu? Fajin e ka prodhuesi. Pra, t'ia lëmë fajin atij që e ka bërë.

Ilir Pendavinji – Po tregtarit, që produktit i ka kaluar afati...?

Vullnet Sinaj – Po, do të vazhdoj, se ka edhe më poshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Vullnet, çfarë propozimi ke për këtë nen?

Vullnet Sinaj – Unë di që Bashkimi Tregtar Shqiptar, i cili sot na ka sjellë propozime për ndryshime, është sot në takim me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Eduard Shalsin. Ata kanë shkuar në takim dhe kanë paraqitur një projekt të ri për këtë ligj. Në këtë moment, ata janë në takim me ministrin dhe kanë sjellë një projektligj të ri, ku ndahet përgjegjësia ndërmjet prodhuesit, importuesit dhe tregtarit.

Sugjeroj që këto përgjegjësi t'i kalojnë prodhuesit. Të mos jenë edhe prodhuesi, edhe tregtari brenda. Thuhet qartë: “Futja e prodhimeve të kimikateve”. Atëherë, kush e bën këtë? E bën prodhuesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë nuk shikoj ndonjë mospërputhje ose ngarkim me faj të disa personave dhe lënie jashtë të disa të tjerëve, sepse, që në krye të fjalisë, thuhet “cilido”, duke futur prodhuesit e deri tek importuesit.

Kam rastin e një të njohuri, që merrej me vaj. Ai merrte vaj luledielli, merrte edhe një sasi koncentratit në Greqi, ia hidhte vajit në maune dhe këtu vinte si vaj ulliri. Vaji merrte shijen,

karakteristikën dhe ngjyrën e vajit të ullirit, vetëm me një bidon 5 litra. Në një maune ai e kontaminonte të gjithin. Nga vaj luledielli ose vaj misri, e shiste për vaj ulliri. Këtë faj e ka importuesi, nuk e ka prodhuesi.

Klerens Janku – Jo në të gjitha rastet.

Ilir Pendavinji – Jo në të gjitha rastet, por ne nuk mund ta përjashtojmë. Duke vënë fjalën “cilido”, edhe tregtuesi, edhe prodhuesi, kushdo të ketë faj, në të gjithë gamën e gjerë këtu, besoj se e parashikon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Pastaj, kush del fajtor është punë tjetër, mund të dalë prodhuesi, por mund të dalë edhe importuesi. Rasti i vajit është shumë flagrant.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti prokuror, keni fjalën.

Artan Syziu – Mendojmë se dispozita është korrekte, madje propozojmë të shtohet edhe për cigaret, sepse mund të ketë cigare që vijnë nga Greqia, për shembull, me rrezatim radioaktiv, me lëndë të parë, që vjen nga fushat e Çernobilit. Nuk është ushqim, por dëmton rëndë shëndetin.

Gjithashtu, mendojmë se neni 288, paragrafi i parë, që është shtuar, është shumë i vonuar. Kjo është një nga dispozitat, që në Kodin Penal ka mbetur “e vdekur”. Kemi pasur shumë dispozita të tjera, kur rrezikohej jeta ose shëndeti i personave, si rasti i personit që nget makinën pa patentë, që penalizohej deri në 3 vjet burg. Ndërkohë, prodhuesit apo importuesit, që kanë kryer shkelje, siç parashikohet tashmë në këtë paragraf, nuk janë penalizuar asnjëherë, sepse dispozita që ishte, e lidhte domosdoshmërisht me pasojën. Pasoja vinte pas disa vitesh. Kështu që dispozita mbetej “e vdekur”. Është shumë e rëndësishme dhe shumë korrekte kjo depozitë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka diçka për të shtuar përfaqësuesi i ministrisë?

Kleves Janku – Jam Kleves Janku nga Ministria e Bujqësisë, përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit.

Para se të vija në këtë komision, isha në grupin e punës të Komisioni i Ligjeve dhe ramë dakord paraprakisht që dy nenet e tjera të hiqen, sepse plotësohen me nenin që sapo u lexua, pra përfshihen aty.

Niko Peleshi – Pra, ju thoni të mbetet vetëm ky nen? Të hiqen nenet e tjera?

Kleves Janku – Po, vetëm ky nen.

Niko Peleshi – A jeni dakord për këtë nen? A keni ndonjë propozim?

Kleves Janku– Edhe ky nen është rikorrigjuar, le të themi, në komision, por në përmbajtje është i njëjtë.

Niko Peleshi – Dakord.

Urdhëro!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të hiqet 21-shi. Ky nen të ngelet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kush është dakord me nenin 20, siç është formuluar në variantin që lexuam?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Për pjesën e cigareve, në dijeninë time, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke punuar për rishikimin e ligjit të mbrojtjes nga duhani. Kështu që atje mund të parashikohet shumë mirë edhe propozimi, por ky nuk është objekt i ligjit...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – T’i fusim edhe cigaret bashkë me ushqimet?

Kush është dakord me këtë riformulim? Në qoftë se nuk jeni dakord, e diskutojmë. Kundër nuk ka.

Miratohet neni 20, sipas formulimit që lexuam.

Kalojmë te neni 21. Neni 21 ndryshon nenin 288. Pas nenit 288/b shtohet neni 288/c/d/e. E kemi të riformuluar këtë nen. Lexojeni kolonën e 4-t.

Po lexoj riformulimin e paragrafit të parë të nenit 288/c: “Cilido që importon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime pas afatit të përdorimit dhe që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në 2 vjet”.

Fjalën e ka zoti Sinaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Kemi prokurorin këtu. Janë hequr fare.

Nëse në Komisionin e Ligjeve janë hequr të dy nenet, kanë bërë mirë.

(Diskutime pa mikrofon)

Po e lexoj: “Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja apo vendosja në qarkullim me ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, barnave, materialeve dhe lëndëve shtesë joushqimore, në prodhimin, përpunimin e ushqimeve pas afatit të përdorimit...”, pra u ka kaluar afati i skadencës. Nuk është njësoj, si në rastin kur një prodhues, që prodhon një produkt ushqimor dhe fut brenda lëndë, që u ka kaluar data e skadencës, kur nuk e shikon klienti, me rastin kur është vendosur malli në raft dhe ka një datë skadence.

A është vepër penale, nëse malli është në raftin e dyqanit dhe e ka datën e skadencës nga kjo datë në këtë datë, kur klienti e shikon dhe nuk e merr? A është njësoj tregtari me prodhuesin në këtë rast, që e bën me qëllim dhe e prodhon produktin me lëndë të skaduara? Nuk mundet!

Edhe në kodin penal italian (jua them unë, se e kam të shkruar) nuk është vepër penale kur produkti është në raft dhe ka një datë skadence, se e shikon qytetari, e shikon klienti. Tjetër gjë bën prodhuesi, që e prodhon atë me produkte të skaduara. Ai është kriminel. Duhet t’i dallojmë gjërat. Nëse janë hequr këto nene, është bërë mirë, përndryshe të mos bëhet ky gabim, se dalim kundër legjislacionit europian.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Nuk është hequr nga ne, por nga një tjetër komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Syziu – Zoti kryetar, ne mendojmë se mund të riformulohen, por dispozitat duhen, sepse, për shembull, kalon afati i skadencës për reçelin e qershisë, e kthen edhe një herë prodhuesi, i ndryshon etiketën dhe e shet. Kjo nuk ka asnjë vlerë ushqimore, madje mund të jetë edhe e rrezikshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është çështje fakti, edhe për atë që e importon, në rast se e di.

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të gjetur fajin, dashjen apo pakujdesinë rast pas rasti, është punë e personave që ushtrojnë ndjekjen penale.

Niko Peleshi – Urdhëro, zoti Valteri, se ta kam ndërprerë fjalën disa herë!

Halit Valteri – Në çdo kod dhe në çdo ligj është për t’u dënuar ai që e shkel ligjin qëllimisht.

Këtu duhet të marrim parasysh edhe shkeljet e ligjit që bëhen për gabime njerëzore, kur punonjësit, për neglizhencë, në një raft marketi, ku ka 30 apo 40 produkte, kanë lënë pa dashje një produkt të skaduar... Kush do të dënohet aty, shitësi, pronari i marketit apo...? Këtu ka një gabim njerëzor.

Zoti prokuror, më fal! Para se të japësh përgjigjet, kemi edhe rastin e gabimit teknologjik, kur prodhuesi e nxjerr në prodhim produktin dhe bën tërheqjen nga tregu të produktit. Në gjithë botën ka raste të tilla. Kompania njofton që ky produkt... Për shembull, kemi rastin e çokollatës Snikers (pa dashur të bëj reklamë), që në gjithë botën tërhoqi mijëra tonelata çokollatë. Në të gjitha vendet po parashikohet legjislacioni, që, nëse është e skaduar ose e prishur, dënohesh... Tani, si do t'i ndajmë këto?

Faleminderit!

Artan Syziu – Dispozita ka parasysh personat që veprojnë me dashje, jo rastet e pakujdesisë. Pastaj hyn në lojë interpretimi rast pas rasti dhe hetimi i çdo fakti konkret. Mendojmë se dispozita, kështu siç është riformuluar, është e nevojshme.

Halit Valteri – Edhe një herë, fola dhe po flas sërish qartë. Tjetër gjë është riformulimi i dispozitës që ka të bëjë me një prodhues, i cili për një produkt të tijin përdor elemente të skaduara, ku nuk i shikon njeri. Në këtë rast, ky bën krim, për mendimin tim, dhe duhet të dënohet. Tjetër gjë është për një produkt në raftet e dyqanit, të cilit i ka kaluar afati i skadencës, por klienti e shikon datën e prodhimit dhe të skadimit. Ku është këtu vepra penale?

Vullnet Sinaj – Ky që thoni ju është një rast konkret, ndërsa në praktikë ka raste të shumta që duhen penalizuar. Duhet mbrojtur interesat e konsumatorit, sepse ka raste kur cenohen dhe askush nuk përgjigjet.

Në rast se importuesi sjell nga Brazili mish që ka 50 vjet në frigorifer, këtu bëhet qofte dhe nuk vjen erë mishi asnjë qofte, sigurisht që do të dënohet, sepse janë bërë miliardë duke na shitur ne mish të kalbur.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, edhe unë kam një pyetje.

Si veprohet në rast të një situatë, ku tregtarë, markete apo supermarkete vendosin me vetëdije të plotë në raftet e tyre ushqime të skaduara, me mendimin që konsumatori nuk do t'i shikojë, sepse, për hir të së vërtetës, kultura e konsumatorit tonë nuk është e tillë që të kontrollojë çdo ushqim që kap me dorë? Konsumatori, për aq kohë sa ekziston shteti dhe institucionet e kontrollit dhe të monitorimit, duhet të thotë “ kur tregtohet në një subjekt të licencuar, nuk kam

nevojë ta lexoj, sepse i konsideroj ushqime të rregullta, të ligjshme, të kontrolluara, të pastra”. Këtë prezumon konsumatori para se të lexojë, të studiojë përmbajtjen e të tjera. Ne duhet të bëjmë çmos të rrisim ndërgjegjësimin dhe kulturën konsumatore, por ai nuk është i detyruar, ne jemi të detyruar të garantojmë që në subjektet e licencuara nga ne, nga institucionet shtetërore, të tregtohen ushqime që plotësojnë normat dhe standardet bazë.

Vullnet Sinaj – Atëherë, ju, kryetar, sikur ai të jetë njeri i çmendur që të vendosë të gjitha mallrat e skaduara në rafte për klientin, sepse, së pari, do të shkatërrojë biznesin e vet, pasi klientët, duke parë që ai e bën gjithmonë këtë gjë, nuk i shkelin më në derë. Pra, është i falimentuar si biznes. Unë po flas për një rast ku është e shprehur qartë edhe në Kodin Penal të Italisë, që e kam studiuar, por edhe në vende të tjera të Europës, që nuk quhet vepër penale kur një produkti rastësor në raft i ka kaluar afati i skadencës, por datën e ka të shkruar qartë, por është kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në të gjithë Europën.

Tjetër gjë është kur prodhuesi fut në prodhimin e produktit të vet elemente të skaduara. Ai e bën me qëllim këtë gjë dhe nuk e shikon dot klienti. Kjo është kundërvajtje penale. Dyqani nuk ka 5 artikuj, por 5 mijë, 6 mijë, 7 mijë, 20 mijë artikuj. Për këtë gjë, ju garantoj. Mund të shkoni të kontrolloni në çdo supermarket të Europës apo në Amerikë dhe do ta gjeni një produkt, sepse ndodh, është një gabim njerëzor, një pakujdesi, por e paqëllimshme. Qytetari shkon për ta blerë, e shikon datën dhe nuk e merr. Fëmijët mësohen në shkollë që para se të konsumojnë një produkt, duhet të shikojnë datën. Ndryshon brezi ynë me brezin që po vjen. Fëmijët që kemi në shkollë nuk pinë asgjë pa e parë datën e skadencës. Pra, ta ndajmë këtë gjë, sepse, nëse do ta lëmë kështu, do të abuzojë AKU-ja kur të shkojë, do të gjejë një mall dhe do t’ua tundë para surratit atyre. Mënyra që po fliste zotëria këtu ishte “shiko, të kam gjetur një produkt të skaduar dhe ti dënohesh me 3 vjet burg”. Është e tmerrshme. Punëdhënësi, që do të marrë një punëtor, do t’i tregojë detyrat e vendit të punës, dhe do t’i thotë: nëse ti zotëri, te vendi yt i punës, te rafti, do të kesh një produkt që i ka ikur data e skadencës, për shembull, ujit, që kemi përpara, do të dënohesh me 3 vjet burg. Kush shkon në punë? Nuk shkon asnjë. Pra, t’i ndani gjërat e bëra me qëllim dhe gjërat e bëra pa dashje. Nëse doni ta bëni lëmsh, bëjeni!

Niko Peleshi – Masa e dënimit është tjetër gjë. Mbase 3 vjet është e ekzagjeruar.

Vullnet Sinaj – Dënojini me gjobë.

Niko Peleshi – Dakord, me gjobë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Fjalën e ka zoti Valteri. Më pas përfaqësuesi i ministrisë dhe zoti Pëllumbi.

Halit Valteri - Unë do të propozoja nëse gjenden sasi të mëdha ose të vendosim një numër, si 3 apo 5 produkte të një rreshti, të cilin nuk e ka prekur fare, sepse nëse gjendet 1 vazo salce në 30 vazo salce, e skaduar me 1 ose 2 ditë... Të vendosim një numër, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Dakord.

Të dëgjojmë edhe zotin Pëllumbi.

Më pas përfaqësuesi i ministrisë.

Arben Pëllumbi – Besoj se kjo dispozitë duhet, por i jap të drejtë edhe kolegut tim Sinaj, që duhet të ndajmë të gjithë gamën, prodhuesin, importuesin, ruajtësin, ofrimin e shitjes, atë që bëhet me qëllim nga ajo që bëhet pa dashje. Importuesi mund të importojë një produkt pa dashje. Pra, ka marrë një certifikatë origjine, që mishi, për të cilin folët ju, ka një dokument të falsifikuar, e importon në Shqipëri, por e ka bërë pa dijeni. Do ta dënojmë me burg importuesin?

Prodhuesi, për të cilin foli zoti Sinaj, ka marrë lëndët e para dhe ka prodhuar produkte të skaduara, por pa dijeninë e tij. Pra, në të gjitha këto raste duhet të ndajmë kur bëhet me dashje dhe kur bëhet pa dashje.

Nëse në raft është vetëm një, ka mbetur pa dashje, por, nëse gjenden 20 produkte të skaduara, nuk është pa dashje. Unë kështu mendoj.

Niko Peleshi – Do ta marrë fjalën drejtori dhe më pas prokurori.

Klerens Janku – Për sa i përket shqetësimit që në rafte gjenden 1 apo 2 produkte të skaduara për 1 apo 2 ditë, kemi vënë termin “rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve”, që do të thotë se edhe nëse është një produkt i vetëm, që rrezikon shëndetin, si për shembull, një pako mishi e skaduar, duhet të dënohet. Në rastet e produkteve, si për shembull, uji, që ka skaduar me 2-3 ditë, apo produkte të tjera, që kanë një tolerancë pas afatit të skadencës, nuk dënohen. Pra, rast pas rasti. Nëse produkti është i rrezikshëm për jetën e njeriut, të dënohen. Nëse nuk është ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Vullnet Sinaj – Kryetar, do të më lejosh të lexoj fjalë për fjalë çfarë thuhet në Kodin Penal italian? Lejohet, apo jo? Nuk ka asnjë gjë të keqe. Nenet nga 439 te 448: Tregtimi i produkteve ushqimore të paketuara, për të cilat ka një datë skadence të llojit, për shembull, “konsumohet brenda datës”, nuk parashikohet si vepër penale, sepse është e tejkaluar data e

skadencës, por vetëm si kundërvajtje administrative e përmendur në nenet më lart dhe dënohet me gjobë”. Ne tani po e bëjmë vepër penale. Nuk e marr vesh.

Artan Syziu – Ju lutem, kjo që lexuat ju nuk është dispozitë, është koment për dispozitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Etiketa për skadencën nuk është e lidhur domosdoshmërisht me skadencën, sepse mund të jetë mashtruese, siç ndodh me ilaçet. Pra, shko në treg sot dhe mund të gjesh të njëjtin medikament në mes të Tiranës 750 lekë, në Laprakë me 300 lekë, sepse janë falsifikuar etiketat. Etiketa nuk është domosdoshmërisht e lidhur me produktin. Pra, dashja është objekt i veprimtarisë së atyre që ushtrojnë ndjekjen penale. Për pakujdesi nuk mund të përgjigjet njeri, sepse ka interpretim. Pra, kjo vepër penale kryhet domosdoshmërisht me dashje. Nga pakujdesia nuk mund të dënohet askush, mjafton të pretendojë se kanë kaluar dy ditë dhe nuk kemi të bëjmë me një veprim me dashje dhe nuk përgjigjet askush, ose është e lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Nuk është vepër penale kur gjen dy paketime me ujë, por, nëse sjell kamionin me produkte të skaduara, sigurisht që do të përgjigjesh, siç ka ndodhur me pulat e ardhura nga Greqia, për të cilat kemi ndotur edhe mjedisin duke i groposur.

Vullnet Sinaj – Ky që bëni ju, zoti prokuror, është koment.

Që ky koment të bëhet ligj, duhet shkruar, duhet ndarë kur bëhet me dashje dhe kur bëhet pa dashje, duhet ndarë prodhuesi nga tregtari, sepse, nëse nuk i shkruajmë gjërat, do të krijojmë premisa më pas që do të na krijojnë probleme. Ligji ose do të bëhet i pavlefshëm, ose nuk do të zbatohet asnjëherë, ose do të krijojmë probleme me qytetarët. Përshtateni siç duhet, që ta bëjmë të vlefshëm këtë ligj. Mos flisni në ajër, pa e ditur si do të jetë rezultati. Ju them unë. Ju merrni gjithmonë një importues që në kokën e vet ka probleme, që është kriminel për mua. Ai duhet të dënohet maksimalisht. Ai që merr...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem! Ndaje!

Do të them unë një rast konkret. Shkon për të blerë produkte në tregun italian. Në një kamion ke 100 produkte. Punëtori i magazinës në Itali, në 100 produkte, ka futur në kamion 10 ose 100 kartonë produkt të skaduar. Duhet të dimë edhe si është realiteti shqiptar, në 100% të produkteve ushqimore që kemi në Shqipëri, rreth 20%-30% kemi produkte vendi, ndërsa 70%-80% i kemi nga importi. Kur ka ardhur ky produkt në kamion i skaduar, ti i thua “dale, të kap

unë te dera e magazinës dhe të fus në burg”. Jo, le ta deklarojë ai që ka ardhur produkt i skaduar. Pra, ndajeni në ligj këtë!

Arben Pëllumbi – Zoti kryetar, mendoj se duhet respektuar këmbëngulja e zotërisë dhe ne sugjerojmë të vendoset në dispozitë “e kryer me dashje”. Më pas, është kryer me dashje apo pa dashje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Se mos dalin të gjithë “pa dashje”, edhe ata që kanë gjysmën e supermarketit me produkte të skaduara.

Artan Syziu – Është rast pas rasti, sepse, edhe të penalizosh për dy konserva një person, është e kryer me dashje. Pra, dashja del nga elementet e anës objektive të veprës penale. Po flas me terma ligjorë.

Niko Peleshi – Mund të penalizohen të gjithë, por penalizohen me gjobë ata që kanë 2 konserva dhe me burg ata që kanë gjysmën e raftëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Propozimi është të hiqen fare të dy nenet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni!

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti drejtor, doje të flisje? Na argumento cila është logjika e propozimit për të hequr dy nenet?

Klevens Janku – Në Komisionin e Ligjeve, me grupin e punës, është menduar që nenet 288/c dhe 288/d të hiqen, pasi përfshihen në nenin 288 më sipër. Pra, nuk do të hiqen, por janë të përfshira, nuk është dublikim le të themi.

Pra, nuk mund të mbajmë dy nene që janë të përfshirë te neni i parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rast se një person helmohet dhe më pas vdes nga ngrënia e një konserve, kush mban përgjegjësi?

Kush e mban përgjegjësinë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Akullorja është produkt i freskët. Është edhe prodhuesi, edhe shitësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa është numri i vdekjeve si pasojë e produkteve ushqimore në Shqipëri gjatë 30 vjetëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Me hetim, del nëse është bërë me dashje apo pa dashje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj - Pra, në rast se nuk vërtetohet në mënyrë të pakundërshtueshme merr pafajësi.

Niko Peleshi – I gjithë merakut është se mos dalin të gjithë sikur e kanë bërë pa dashje. Pra, mos ka shteg për të dalë të gjithë që e kanë bërë atë veprim pa dashje?

Vullnet Sinaj – Nuk mund të dalin.

Niko Peleshi – Dalin, sepse mund të ketë justifikime të tilla, si: nuk e dija, magazinieri, dy raftë nuk i kontrolloam e të tjera.

Vullnet Sinaj – Atëherë, t’i fusim sikur e kanë bërë të gjithë me dashje.

Niko Peleshi – Jo, të gjithë me dashje, por të ndryshojë nga masa e ...

Vullnet Sinaj – Nëse vërtetohet që dikush ka bërë një veprim me dashje, atëherë le të dënohet maksimalisht.

Niko Peleshi – Asnjë nuk do të dalë që e ka bërë me qëllim. Për 10 vjet, po të marrim statistikën, nuk do të dalë asnjë i bërë me qëllim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj - ... t’i fusim punëtorët në burg me radhë. Janë mijëra dyqane ushqimore në tregun shqiptar.

Niko Peleshi – Masa e dënimit është tjetër gjë. Pse jo me gjobë?

Vullnet Sinaj – Me gjobë jam dakord.

Niko Peleshi – Po pagoi njëherë gjobën, herë tjetër ...

Vullnet Sinaj – Gjobë po, por jo burg.

Niko Peleshi – Të fillojë nga gjobë dhe deri me burg kur është ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu e kemi “dënohet me burgim deri në dy vjet”, kurse tani të themi “dënohet me gjobë deri në burgim deri në 2 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E hedhim në votim nenin 21.

Kush është dakord në parim që të qëndrojmë si nen? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 288/c, për të cilin diskutuam.

Hedhim në votim propozimin që masa e dënimit të fillojë nga gjobë deri në dy vjet burg. Në këtë diapazon, kemi nga veprim i kryer pa dashje apo pakujdesia deri në i kryer me dashje për qëllime fitimi e të tjera.

Kush është dakord me këtë formulim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, shtohet gjoba, pastaj e ndan hetimi dënimin.

Neni 288/d.

Mashtrimi me produktet ushqimore.

“Cilido që importon, prodhon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime, në të cilën janë shënuar të dhëna, të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin e posaçëm, ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketën e produkteve ushqimore dhe që rrezikojnë shëndetin, dënohet me burgim deri në tre vjet”.

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj - Duhet vendosur edhe këtu fjala “gjobë”, sepse nuk mund ta fusim direkt në burg pse ka bërë një gabim në përkthim. Në fillim të dënohet me gjobë, pastaj burg. Nëse ai ka bërë falsifikim apo një gjë kundër ...

Niko Peleshi – Manjola, Xhilda, keni ndonjë ... ?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu flitet për mashtrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në titull lexon “mashtrim”, sepse në tekst nuk thuhet mashtrim. Këtu thuhet: “Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, barnave, materialeve dhe lëndëve shtesë jo ushqimore në prodhimin, përpunimin e ushqimeve, në të cilat janë shënuar të dhëna, të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ose paraqitja e të dhënave të rreme ose

paraqitja e të dhënave të rreme në etiketimin e produkteve ushqimore”. Domethënë, nëse jep të dhëna të rreme shkon në burg, nëse ka bërë diçka pa dashje, paguan gjobë.

Vullnet Sinaj – Këtë lexova edhe unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të fundit fare, pra. Ndahet me lidhëzën “ose”. “Ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketën e produkteve ushqimore”.

Pra, nëse nuk i ka bërë përkthimet në rregull sipas origjinës ose ka vënë të dhëna të rreme. Për pjesën e parë ka bërë gabim dhe të gjobitet, kurse pjesën e dytë të bëjë burg. Janë dy variante dhe ndahet përshkrimi i fajit. E vendosim gjobë ose burg deri në tre vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

80% e produkteve në treg vijnë nga importi. Për një gabim që bën pa dashje përkthyesi shkon në burg, por edhe ai që i bën të rreme me dashje shkon në burg. Ky duhet të dënohet me gjobë. Janë të vetmet nene ku nuk ka gjobë dhe burg. Të gjitha nenet e mësipërme kanë gjobë ose burg, kurse këtu kemi vetëm burg.

Arben Pëllumbi – Mendoj që ky nen ka nevojë për një aneks, sepse nuk mund të sillet kaq thatë sa po na vjen ne. T’i saktësojmë të gjitha, sepse po flasim për sigurinë ushqimore dhe jo për... Mund të bëjmë njëmijë e një komente, por këtu flitet për jetë njeriu.

Së pari, duhen ndarë nga njëra-tjetra. Ne po lëmë pa përmendur “produktet bio”, si për shembull, vaji i ullirit, mjalti, rakia, reçeli, gjalpi e të tjera. Ne po merremi me mallrat e importit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po plotësoj Vullnetin dhe po merrem ekzaktësisht me atë që duhet të merremi ne sot. Kush e kontrollon gjalpin? Njeriu që prodhon gjalpin, mjaltin, vajin e ullirit e bën për mbijetesë. Edhe nëse ne vendosim dënim me 200 vjet burg, nevoja e tij për të mbijetuar kalon çdo ligj. Ai do të shesë atë që prodhon dhe do të bëjë hilenë, sepse do të ulë koston e prodhimit që të fitojë sa më shumë. Si do ta ndajmë këtë gjë?

Faleminderit kryetar!

Niko Peleshi – Keni ndonjë propozim si mund të ndahet?

Jam dakord me zotin Sinaj që ka një ekuivok.

Arben Pëllumbi – E thashë edhe më parë, nevoja e atij njeriu për të fituar ato para që t’i çojë në shtëpi e tejkalon gjobën. Nuk ia vendos dot gjobën ngastrës që ka në dorë. Të gjithëve na

ka rastisur të shkojmë në plazh në Jug dhe të shikojmë kavanozat e mjaltit, por vetëm mjaltë nuk ka.

Niko Peleshi – Mund ta shtojmë në këtë rast fjalën “me dashje”, sepse këtu është lehtësisht e vërtetueshme nëse dikush ka mashtruar me dashje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevens Janku - Ka dispozita të përgjithshme për mashtrimin, neni 143 e vijues të Kodit Penal.

Kur thua mashtrim është një formë vjedhjeje, që ndryshon nga vjedhja, sepse ia jep vetë paratë atij që të mashtron. Ia merr me anë të gënjeshtërs dhe besimit të tepruar. Ti i beson blerësit, i jep paratë dhe ai të jep vaj palme ose margarinë në vend të gjalpit.

Niko Peleshi - Fjala mashtrim është vetëm në titull dhe jo në përmbajtje. Unë nuk e di si shkruhet në Teknikën Legjislative.

Esmeralda Velaj – Keni shumë të drejtë në atë që thoni që duhet vetëm fjala “dashje”, pasi ligji për ushqimin ka një dispozitë që e ngarkon edhe subjektin shitës me një sistem vetëkontrolli që duhet t’ia bëjë mallit, pasi skandenca hyn te garancitë e sigurisë ushqimore, ku përfshihet edhe dëmi edhe humbasin vlerat ushqyese. Kështu që, vetë ligji administrativ, një ligj i posaçëm e ngarkon edhe shitësin që të bëjë një vetëkontroll dhe të bashkëpunojë për heqjen e mallrave. Prandaj duhet “me dashje”, që do të thotë se ti, në mënyrë të qëllimshme e lejon. Atëherë kjo është shkallë më e lartë e rrezikshmërisë dhe mund të parashikohet edhe penalisht.

Niko Peleshi – Si mendoni?

Arben Pëllumbi – A është në rregull nga ana legjislative kur titulli është mashtrim...

Esmeralda Velaj – Nuk po flisim për mashtrimin, se është dispozitë më vete, unë po flisja për dispozitën lidhur më të skaduarat.

Niko Peleshi – Këtu jemi te pika e mashtrimit.

Arben Pëllumbi – Kolegë të nderuar, vërtet po flasim për mashtrimin, por ai nuk e ka fare konceptin e mashtrimit, ai po bën tregti, shet tre kavanoza mjalti ose 10 kokrra vezë, apo 5 kg vaj ulliri për të mbajtur fëmijët dhe nuk e sheh fare pjesën e mashtrimit as nuk ka për ta lexuar ndonjëherë këtë ligj që po bëjmë këtu.

Klevens Janku – E thënë me fjalë të thjeshta ti jep më shumë para dhe merr më pak mall. Më përpara ka qenë një dispozitë “mashtrim në peshë e në matje” dhe kjo dispozitë, zëvendëson në njëfarë mënyre atë dispozitë.

Pra, të jep më pak mall, kështu që mund të mashtrojë si në peshë, ashtu dhe në cilësi. Për shembull, ti shkon të blesh djathë, por në fakt po blen niseshte. Kjo është logjika.

Niko Peleshi - Kam një propozim. Duket që ky paragraf ka dy pjesë dhe përsërisin njëra-tjetrën. Tek e para janë dy interpretime, se nuk përmendet fjala mashttrim apo të dhëna të rreme, kurse më poshtë flitet për të dhëna të rreme në etiketën e produkteve ushqimore, që rrezikojnë shëndetin, etj. Sikur t'i bashkojmë në një dhe ta formulojmë kështu: “Cilido që, importon, ruan, prodhon, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime në të cilat janë shënuar të dhëna të rreme...” të shtojmë këtu fjalën “të rreme” “...të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohen në legjislacionin e posaçëm, dënohet me burgim deri në 3 vjet”.

Pra, ta heqim fjalinë “ose paraqitje e të dhënave të rreme në etiketën e produkteve ushqimore që rrezikojnë shëndetin”, sepse supozohet që tek e para të dhënat janë të rreme nëse nuk përputhen me përmbajtjen e produktit. Nuk e di cili është dallimi mes te dyjave, po t'i shkrijmë të dyja në një, atëherë këtu merr përgjigje shqetësimi që kemi “me apo pa dashje”, nëse themi “të rreme” atëherë do të thotë që bëhet me dashje.

Arben Pëllumbi - Nuk do ta zgjas shumë, thjesht kam një ndërhyrje, sepse këtu po flasim për ligje, për burg apo se si ta rregullojmë këtë gjë, por harrojmë që jashtë kësaj salle është një realitet komplet ndryshe. Ka disa njerëz të varfër që tregtojnë në tezga ambulante dhe nuk mendoj se burgu, që përmendim ne, e rregullon tregun. Nuk është kjo e vetmja zgjidhje, sepse tregu rregullohet nga rritja ekonomike që ka vendi dhe është përgjegjësi jona dhe juaja, por edhe e atyre që kanë qenë para nesh, të mos e kërcënojmë atë me burg që të mos e bëjë këtë gjë. Unë hapa çështjen e ushqimeve bio pas së cilës turremi të gjithë me vrap. Secili nga ne gënjehet nga marka bio dhe vrapojmë ku të jetë fshati më i afërt për të marrë qumështin, vezën etj, por kush e rregullon këtë pjesë, se kemi 6 orë që diskutojmë për konservat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, i ke në çdo tezgë dhe dyqane që thonë “produkte bio”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë paskemi mashtrules të certifikuar!

Gjithsesi kjo pjesa e burgut më duket e tepërt, nuk është se po zgjidhim gjë.

Niko Peleshi – Siguria ushqimore është pjesë e sigurisë kombëtare dhe ndjeshmëria është shumë e madhe, sepse është problem shumë i madh dhe shumë mirë që konsumatori shqiptar ka ndjeshmëri, pasi kjo na bën ne, si ligjvënës dhe institucionet ekzekutive, të impenjohemi më shumë për të forcuar kuadrin ligjor. Diskutimi që ju bëni është në parim, ne e diskutuam me parë në parim dhe ramë dakord që ka nevojë për ndryshime ligjore dhe forcim të Kodit Penal në këtë pikë.

Mendoj të ecim me propozimin që lexova, nëse rrëzohet e hapim prapë diskutimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka kuorum as për votimin as për mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, propozohet që neni 21 të riformulohet si më poshtë: “Cilido që importon, prodhon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime në të cilat janë shënuar të dhëna të rreme, të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë apo cilësisë së produktit, apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin e posaçëm dhe që rrezikojnë shëndetin, dënohet me burgim deri në tre vjet.”

Heqim pjesën: “ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketën e produkteve ushqimore”, sepse është përsëritje dhe shtojmë fjalën “të rreme”.

Kush është dakord të miratohet siç është formuluar në variantin e përpunuar, pra sipas kolonës 4?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet. Atëherë, shtuam fjalën “të rreme”, e cila nënkupton ato që janë me dashje në mënyrë që të jemi konform titullit të nenit, “Mashtrimi me produktet ushqimore”.

Kalojmë te neni 288/e, “Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë të organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore”.

“Thyerja, heqja, zëvendësimi, ndërrimi ose falsifikimi i shenjave të sigurisë të vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikëqyrjeje ose kontrolli ose pezullimi të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike, mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim zhvleftësimin e masave të marra, lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet për mallra të kontaminuara ose të paidentifikuara, dënohet me burgim deri në pesë vjet."

Çfarë mendoni për këtë nen?

Kush është dakord të miratohet? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22, që i referohet nenit 293, si vijon:

"Neni 293

Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit

Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet".

Kush është dakord?

Ka një koment.

Urdhëroni!

Halit Valteri – Ky nen lë të hapur rrugën për të futur në burg këdo, që ka përcaktuar dhe nuk ka të përcaktuar se çfarë e shkakton bllokimin e rrugës ose ndalimi i qarkullimit rrugor, ajror apo detar, që e konsiderojmë vepër penale. Nëse votohet ky ndryshim, mund të sjellë diktaturën, sepse çdo protestë qytetare për të cilën policia juaj nuk do të japë leje, do të konsiderohet vepër penale. Çdo qytetar që parkon makinën gabim, i bie që të futet në burg, sepse masa e dënimit që shkaktohet nga kjo vepër penale në mënyrë që të na dëmtojë kaq shumë? Ku është reflektuar parimi kushtetues i proporcionalitetit?

Po atyre që u fiket makina në rrugë, edhe ata do t'i fusim në burg? Marr si shembull protestat e fundit. Ata kanë të drejtë, se edhe qytetarët që protestojnë me opozitën, do të dalin në datën 8 për të protestuar. Janë përgjimet që dolën dje, që janë skandali më i madh. Çfarë do të bëjmë? Edhe ata që do të protestojnë atje do t'i fusim në burg?

Niko Peleshi – Më falni! Ky nuk është nen kundër protestës.

Halit Valteri – Të lutem! Ta mbaroj!

Protestë është, sepse ata kanë të drejtën e tyre të protestojnë kundër qeverisë "Rama". Unë jam shumë dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merret leje.

Zoti Pëllumbi, leja jepet për 2-3 orë ose nuk jepet fare. Ai do të protestojë, se ka të drejtën e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju jap rastin e fundit, zoti Beqaj, se po ju drejtohem edhe juve. Përgjimet e fundit, që e nxjerrin Vangjush Dakon duke folur me kriminelët janë pasqyra e vetme se si ka ardhur kjo qeveri në pushtet, se si kriminelët kanë ndikuar në vendosjen e listave të deputetëve, të kryetarëve të bashkive, si i kanë blerë votat për llogari të Edi Ramës, si kanë urdhëruar administratën publike që të shkojë te zyrat e PS-së dhe të votojë për PS-në. Këto thuhet te përgjimet. Të gjithë e dinë këtë gjë, edhe për favoret shtetërore kundër ligjit, sepse shqiptarët janë pa bukë, pa punë, po ikin çdo ditë dhe t'u heqin edhe të drejtën e protestës dhe t'u themi se nëse ti del dhe proteston atje, zë rrugën kryesore, do të hysh në burg, nuk ka kuptim fare. Për mendimin tim, kjo, nëse keni sadopak ndërgjegje, nuk është në të mirë të vendit, se edhe ju keni qenë në opozitë. Ju keni bllokuar rrugë, sheshe, keni djegur goma, keni dhunuar institucionet dhe asnjëri nuk është futur në burg, por thjesht kanë dalë me detyrim paraqitje, siç është procedura.

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Duhet diskutuar disa momente.

E para, në Shqipëri nuk merret leje për protestë, por njoftohet. Kjo është zgjidhur prej kohësh. Ka shumë e shumë vite që ti njofton. Sigurisht, ai që merr përsipër të organizojë protestën, sidomos kur është një parti politike, duhet t'i dalë për zot protestës. Të mos çojë në protestë njerëz të maskuar, se është e ndaluar të jesh i maskuar në protestë, të mos përdorë mjete piroteknike të dëmshme për shëndetin e kujtdo pjestari të forcave të sigurisë dhe të rendit, qytetari të thjeshtë dhe protestuesve, aq më shumë, të përdorë edhe fëmijët në protestë.

Po, ka qenë edhe PS-ja, edhe unë në opozitë dhe nuk mbaj mend ndonjëherë të kemi marrë fëmijë për t'i nxjerrë në protestë apo të kemi dhunuar ndonjë institucion ndonjëherë. Nuk u prek asgjë nga Kryeministria në protestën e 21 janarit, por u vranë 4 veta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se të dëgjova!

Janë edhe pamjet publike atje. Kryeministria nuk u prek fare siç digjet çdo javë, por është zgjedhja e atyre që kanë vendosur të bëjnë protestë.

Në lidhje me përgjimet, nëse duam të shkojmë drejt një shteti ligjor, në radhë të parë, kush ka prova, i çon në prokurori. Nëse prokuroria mendon se duhen çuar në gjykatë, i çon atje dhe pastaj është gjykata që merr vendimin. Mua më ka çuar në gjykatë kundërshtari politik edhe kur kam qenë në opozitë, edhe kur kam qenë në pushtet. Unë personalisht kam pritur vendimin e gjykatës dhe të prokurorisë.

Edhe në këtë rast, aq më shumë që është evidente, që këto që na dalkan sot si zbulime të medias, i ka prokuroria prej 2 vjetësh dhe i ka mbajtur aty për t'i përdorur politikisht. I nxorën një herë në shkurt (provat e dosjes), sikur ishin të Zërit të Amerikës dhe tani po i nxjerrin (ka 2 vjet që po fle dosja atje), sikur janë të një gazetari gjerman. Ato janë materiale të dosjes së prokurorisë dhe ata persona që përmendjen aty, sipas njoftimeve publike, janë thirrur për të dëshmuar dhe sot ka njerëz, që kërkohet të çohen për gjykim.

Vetë dispozita thotë: “Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë...” Nuk është një mjet që priset në rrugë. Është vënë enkas me çdo mjet e mënyrë, jo rastësisht, siç mund t'i ndodhë kujtdo. Priset dhe merr flakë një mjet i vjetër, një mjet i përdorur.

Edhe kur ka një aksident pengohet, por karamboli nuk është vënie pengese me çdo mjet e mënyrë, se nëse çdokush do të marrë përsipër të krijojë një pengesë të jetës së përditshme, nuk mund të funksionojë kështu, se në asnjë vend nuk funksionon kështu, edhe në demokracitë e zhvilluara, edhe në demokracitë që janë në rrugën e zhvillimit dhe të konsolidimit.

Në lidhje me faktin se si janë fituar zgjedhjet e vitit 2017, këtu kemi qenë të gjithë. Unë nuk di ndonjë komisioner në 5500 qendra votimi që ka Shqipëria të ketë shënuar që ka pasur ndonjë parregullsi në ndonjërin nga qendrat. Një të vetme nuk ka. Zgjedhjet e vitit 2017 janë të vetmet që nuk kanë pasur asnjë kundërshti në komisione dhe në nivelet e tjera të apelimit, siç i ka Kodi ynë Zgjedhor.

Kështu, unë mendoj të mbajmë këtë dispozitë. Sigurisht, ne jemi politikanë dhe shfrytëzojmë çdo moment kur na jepet mundësia sipas Rregullores dhe hapësirës që ka jeta parlamentare për të bërë politikë, për të çuar mesazhet tona politike, për të folur me shqiptarët dhe me elektoratin.

Në rastin konkret, unë mendoj se dispozita është e qartë dhe nuk i cenon liritë dhe të drejtat e njeriut, nuk është kthim mbrapa nga ajo që shqiptarët kanë arritur me mund në këta 28 -

30 vjet. Shpërdorimi i të drejtave, i hapësirës demokratike në kurriz të të tjerëve, duhet të gjejë një lloj balance.

Faleminderit!

Artan Syziu – Të lutem, kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këtë nen nuk ka vend të diskutohet fare, sepse është në Kodin Penal që kur ka hyrë në fuqi Kodi Penal i vitit 1995. Unë habitem pse e kanë vënë, se është i njëjti tekst. “Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kishte nevojë fare të vihej në projektligj. Kush e ka Kodin Penal, mund ta lexojë. Është vënë që në vitin 1995. Nuk lë shteg as për diskutim të mëtejshëm. Siç ka qenë është njësoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – I bie që është zbutur, nuk është rënduar.

Artan Syziu – Është thjesht një kopjim i dispozitës ekzistuese të Kodit Penal. Nuk sjell asnjë ndryshim.

Niko Peleshi – Më fal!

Kam një pyetje: a është e vërtetë që është ndryshuar lidhëza nga “dhe” në “ose”?

Ky nuk është ndryshim i vogël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Syziu – Kjo nuk e ndryshon dispozitën. Dispozita nuk ka ndryshim.

Niko Peleshi – Na thoni se çfarë ndryshimi ka!

E kam fjalën: a është e vërtetë që është ndryshuar lidhëza “dhe” në “ose”, pra gjobë edhe burgim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka ndryshim në masën e dënimit? Dakord.

Urdhëroni!

Halit Valteri – Për të sqaruar zotin Beqaj, por marr vetëm një rast, përveç pjesës që juve ju ka ikur kujtesa më 21 janar, kur kishte më shumë hunj në bulevard, sesa njerëz me të cilët i gjuanin policisë. Do t’ju sjell edhe fakte të marra nga mediet dhe do t’jua çoj me telefon. Po ju

them se nuk kishte nevojë të shkonte te shënimi i komisionerit, se ai kishte 3 muaj që e kishin mbyllur punën. Edhe përgjimi i Avdyllajve thotë: “Si do ta zgjidhim këtë? Të dua fort vëllai im. Votat do t’i bëj këtu apo atje.”

Unë po marr vetëm rastin e protestuesve të Astirit, që më shqetëson shumë se një pjesë janë të zonës, ku unë jam zgjedhur deputet. Pasi të miratohet kjo, ata njerëz që dalin dhe protestojnë, bllokojnë rrugën çdo ditë në orën 18:00 për të drejtat e tyre dhe të familjeve të tyre, për shtëpitë që po u prishen nga një megaskandal, një projekt me çmimin 20 milionë euro për kilometër që ka paraqitur qeveria. Çdo të ndodhë me këta? Do t’i arrestojmë të gjithë këta që protestojnë për të mbrojtur çatinë, ku fusin kokën?

Dua një përgjigje konkrete për këta, kjo retorikë. Çfarë do të ndodhë me banorët e Astirit, që protestojnë, bllokojnë rrugën çdo ditë në orën 18:00 për të drejtat e tyre, për shtëpitë, që po u prishen nga një megaskandal, të cilin ju një herë e anuloni dhe një herë e shpallni përsëri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Valteri, që të mos e ...

Halit Valteri – Kjo lidhet me nenin. Dua një përgjigje.

Niko Peleshi – Nuk është puna e përgjigjes. Këtu nuk bëhet fjalë për një tubim, qoftë ky i lajmëruar, qoftë i pa lajmëruar.

Halit Valteri – Është i pa lajmëruar.

Niko Peleshi – Ky nen nuk merret me tubimet dhe nuk ka synim të pengojë të drejtën demokratike të protestës, por merret me bllokimin e rrugës me mjete penguese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky nen thotë se nuk mund të bllokohet rruga me mjete penguese, nuk lejohet ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujqor e ajror. Në të kundërt, do të gjobitesh. Aq më shumë, që paska qenë një dispozitë e ngjashme në Kodin Penal. Nuk besoj se ka ndonjë vend në Europë që nuk e dënon bllokimin e rrugës.

Nëse dikush bllokoi një autostradë në Gjermani, ti mendon se nuk do të marrë as gjobë?

Halit Valteri – Në të gjithë Europën, si në Francë, si në Itali apo në Greqi, të digjet qyteti dhe të bllokohet qyteti dhe kur vjen puna nuk ka nga këto. Për çfarë po bëhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po i shohim çdo ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si reagon shtetit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi dëgjuar ndonjëherë të arrestohen 300 veta, siç i arreston Sandër Lleshaj brenda natës. Nuk kemi informacion të tillë. Nuk ndodh kjo gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urdhëroni, për procedurë!

Ilir Pendavinji – Ka një teknikë legislative. Duhet të futemi në procedurën normale. Hidhet në votim: pro, kundër, abstenim, siç është rregulli. Nuk bëhet dot debat mes anëtarëve të komisionit, sepse ne politikisht mund të flasim shumë, por asnjëri nuk ka nge, sepse kaloi një kohë e gjatë dhe mbase humbet vëmendja nga çështja kryesore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që mërzitem, sepse po ngec edhe rrjedha normale e punës së komisionit, që është një komision shumë teknik.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Valteri, ju lutem!

Nuk është mirë që në këtë komision të diskutojmë: ju dhe ne. Deri tani nuk e kemi pasur këtë frymë. Këtu jemi një komision.

Natyrisht, zoti Beqaj, ka të drejtë kur thotë që kemi përkatësi politike dhe sa herë kemi para një mikrofon dhe një kamera përballë, kujdesemi të japim mesazhe politike. Këtu, siç e tha zoti Pendavinji, jemi në një vendimmarrje teknike.

Ne kemi qasjen tonë politike, por në fund fare duhet të diskutojmë teknikisht, sepse bëhet fjalë për një Kod Penal, që nuk ndryshohet dot kollaj, se do një numër të caktuar votash, që jo gjithmonë bëhen bashkë në parlament.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Valteri, ju mendoni se ne kemi kufizuar hapësirat këtu?

Zoti Pendavinji ngaqë është anëtar zëvendësues në këtë komision, po çuditet me demokracinë e këtij komisioni, prandaj foli kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ka mundësi që bëri kritikë ndaj meje? Unë jam demokrat i pandreqshëm. Kështu do të vazhdojmë, me hapësira të pakufizuara. E kam fjalën që të mos ta ekzagjerojmë, se këtu nuk bëhet fjalë për të cenuar të drejtën e protestës, por për të vënë disa kufizime, madje unë e kam ditur që masa për bllokimin e rrugëve ishte më e rëndë, por paska mbetur siç ka qenë në kodin ekzistues.

Nëse e lëmë të lirë, për një problem sado të vogël të një komuniteti apo të një grupi interesi, dalin dhe e bllokojnë rrugën kombëtare dhe nuk ke se çfarë ju bën.

Të gjitha mjetet e tjera të protestës janë të lejuara. Ky mjet i bllokimit të rrugës kombëtare (nuk është se e kam lexuar të gjithë legjislacionin europian), por jam i sigurt që në një vend tjetër nuk është kaq e kollajshme të bllokosh rrugën nacionale, se ti ke të drejtë të protestosh, por të tjerët kanë nevojë të qarkullojnë dhe të zhvillojnë jetën normale. Pra, nuk duhet të cenosh të drejtën e dikujt tjetër.

Megjithatë, nuk është e thënë të jemi të gjithë në një mendje dhe t'i shohim gjërat njësoj. Ju e thatë mendimin tuaj. Nëse ka ndonjë propozim tjetër, jeni të mirëpritur. Në të kundërt e hedhim në votë.

Zonja Gjermani, kishit diçka për të thënë?

Eglantina Gjermani - Nuk bëhet fjalë vetëm për transportin rrugor, por edhe për transportin ajror, hekurudhor. Të ndalojë dikush avionin, anijen apo trenin, sigurisht që do të merren masa, se prandaj është shteti.

Halit Valteri – Një ndërhyrje. Avioni le të niset. Ai ka ndaluar vetëm kur kanë vjedhur 10-15 milionë euro brenda aeroportit.

Protestat e opozitës, apo ato të qytetarëve që dalin në rrugë nuk kanë punë as me avionë, as me trenat. Ata që bashkëpunojnë me shtetin dhe vjedhin nga 10 milionë euro, ata mund ta pengojnë nisjen e avionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, pra. Unë po të përgjigjem për pjesën e avionit. Nëse dikush ka penguar nisjen e avionit, kanë qenë ata me maska që kanë vjedhur 10 milionë euro.

Niko Peleshi – Këtu bëhet fjalë për një ndryshim Kodi, i cili nuk bëhet për opozitën, por do të jetë për opozitën e sotme, për opozitën e nesërme, për atë pas pesë vjetësh, atë pas dhjetë vjetësh, se kushedi sa vite duhet të kalojnë për t'u bërë 84 vota bashkë për të ndryshuar një kod.

Ky nuk është një vendim i Këshillit të Ministrave, ku thuhet se qeveria merr një vendim të pengojë opozitën, por është një ndryshim Kodi. Ky vlen për disa qeveri dhe disa opozita që do të pasojnë.

Gjithsesi, kush është dakord me nenin 22, siç është formuluar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Valteri, zoti Çarçani, zoti Shtjefni, jeni kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tri vota kundër.

Miratohet neni, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kalojmë te neni 23 “Hyrja në fuqi”: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Shumë faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, të mbaroj fjalën!

Ju kërkojmë ndjesë për zgjatjen e kësaj mbledhjeje, por bëhej fjalë për një projektligj shumë të rëndësishëm, për një Kod, ndaj e meritonte të gjithë kontributin tuaj, për të cilin ju falënderoj edhe kur nuk ramë dakord, edhe kur, në shumicën e rasteve, ramë dakord!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti prokuror, urdhëroni!

Artan Syziu – Krahas këtyre ndryshimeve, duhet me patjetër të ndryshojë dispozita për prerjen e paligjshme të pyjeve, sepse është një dispozitë anakronike. Ne mendojmë që të mbrosh ujërat, faunën dhe florën është e pamundur pa mbrojtur pyjet. Ndaj, dispozita në Kodin Penal

është absolutisht e pazbatueshme, sepse parashikon kushtin e marrjes më përpara të masave administrative, ndërkohë që parashikon vetëm gjopa dhe dënime minimale.

Ne mendojmë që është e papranueshme të ketë dënime shumë të rënda për ata që dëmtojnë tokën, faunën, mjedisin, ndërkohë që ka dënime krejt minimale ose të papërfillshme për mbrojtjen e pyjeve. Kjo sepse gjykojmë që prerja e paligjshme e pyjeve cenon shumë interesa: cenon marrëdhënie juridike të rëndësishme, si mjedisin, por është edhe pronë që kthehet në dobi të atyre që e vjedhin, e marrin dhe e tregtojnë.

Pra, kjo dispozitë sot është e pazbatueshme, ndërkohë që, praktikisht, ndodhin paradokse të tilla, si: ai që shkon e merr lëndën drusore të prerë, dënohet për vjedhje, ndërkohë ai që e pret dhe e çon në magazinën e tij për ta shitur, më pas dënohet maksimumi për një kundërvajtje penale. Në fakt, dispozita është krejt e pazbatueshme. Prandaj ne kemi bërë propozime konkrete dhe, e theksoj, pasi mendoj se duhet të dalë nga ky komision, që e ka objekt specifik, që të ndryshojë dhe të përmirësojë dispozita për pyjet.

Propozimin e kemi edhe me shkrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Më falni, zonja Pinci!

Atëherë, ne e miratuam projektligjin edhe në tërësi, ndërkohë do të ketë një relacion shoqërues për Komisionin e Ligjeve. Në qoftë se edhe anëtarët e komisionit bien dakord, unë propozoj që në relacion të përfshihet edhe ky rekomandim, për shkak se ka lidhje të drejtpërdrejta me fushëveprimin e komisionit tonë. Të mos bëjmë riformulim, se edhe e mbyllëm diskutimin dhe votimin, por t'i kërkojmë Komisionit të Ligjeve të rishikojë dispozitën për kundërvajtjet penale lidhur me prerjen e paligjshme të pyjeve dhe të formulojë një dispozitë me masa të përforcuara, në qoftë se edhe ata e gjykojnë të arsyeshme.

Përndryshe, kemi rezervën e seancës, ku do t'ju lutesha të na e vini në dispozicion propozimin tuaj. Pastaj, njëri nga ne ose unë personalisht, ose disa deputetë bashkë, mund ta ngremë si çështje në seancë plenare dhe të kërkojmë të shtohet.

Artan Syziu – Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit juve!

E mbyllim këtë seancë të parë.

Në qoftë se jeni dakord, bëjmë edhe një seancë tjetër të shkurtër për miratimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019”. Si mendoni?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, mbyllim seancën e parë dhe fillojmë tjetrën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është seancë tjetër, sepse bëhet shumë e gjatë seanca.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Besnik Baraj

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Elona Toto